



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME**



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË

DISERTACION

Për Marrjen e Gradës Shkencore

DOKTOR

“HEMODIALIZA DHE RISKU PËR AVC”

Kandidati:

Fjona NASTO

Udhëheqës shkencor:

Prof.Dr. Nestor THERESKA

Tiranë 2022



UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË



FAKULTETI I MJEKËSISË
Njësia e Projekteve dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI MJEKËSISË, TIRANË
FAKULTETI I MJEKËSISË
DEPARTAMENTI I SËMUNDJEVE TË BRENDSHME**

DISERTACION

I paraqitur nga:

Znj. FJONA NASTO

Për marrjen e gradës shkencore

DOKTOR

Specialiteti - NEFROLOGJI

Tema:

**“AKSIDENTET CEREBRO-VASKULARE TEK
PACIENTËT NË HEMODIALIZË”**

Mbrohet në datë ___/___/2022 PARA JURISË

- | | |
|-----------------------------|----------------|
| 1. PROF. MYFTAR BARBULLUSHI | KRYETAR |
| 2. PROF. ALMA IDRIZI | ANËTAR Oponent |
| 3. PROF. MEHDI ALIMEHMETI | ANËTAR Oponent |
| 4. PROF. ELIZIANA PETRELA | ANËTAR |
| 5. PROF. ALBAN DIBRA | ANËTAR |

TABELA E PËRMBAJTJES

Tabela e Përmbajtjes.....	iii
I-DEFINICIONI DHE KLASIFIKIMI I AKSIDENTEVE VASKULARE CEREBRALE..	5
1.1 -Përkufizimi i infarkt të SNQ:	8
1.2 -Përkufizimi i stroke ishemike:.....	9
1.3 -Përkufizimi i infarkt të heshtur të SNQ.....	9
1.4- Përkufizimi i hemorragjisë intracerebrale:	9
1.5- Përkufizimi i hemorragjisë cerebrale të heshtur:.....	10
1.6- Përkufizimi i hemorragjisë subarahnoidale:	10
1.7- Përkufizimi i stroke të shkaktuar nga tromboza venoze cerebrale:.....	10
1.8- Përkufizimi i stroke qe nuk specifikohet ndryshe:	10
1.9- Përkufizimi i TIA	10
II. INCIDENCA, PREVALENCA, MORTALITETI I STROKE DHE TIPET E TIJ NE POPULLATEN E GJERE	11
2.1 Te gjitha llojet e STROKE.....	12
2.2 STROKE ISHEMIK	15
2.3 STROKE HEMORRAGJIK (Hemorragjia e kombinuar araknoidale dhe intracerebrale)	16
2.4 Situata ne Shqipëri	18
III-INCIDENCA PREVALENCA MORTALITETI I STROKE NE ESRD DHE DIALIZE NE BOTE	20
IV-DIAGNOSTIKIMI DHE RADIOLOGJIA.....	29
4.1 Koha dhe Imazhet	29
4.2 Diagnoza Klinike	30
4.3 Diagnoza Radiografike	31
V- PATOLOGJIA DHE MEKANIZMAT PER AVC	39
VI – FAKTORET E RISKUT	48
6.1 Moshë dhe gjinia.....	51
6.2 Procesi I Hemodializës, si një nga faktorët me të rëndësishëm për STROKE	51
6.3 Aksesit vaskular dhe stroke.....	53
6.4 Hipertensioni, HTA	53
6.5 Hiperkolesterolemia.....	53
6.6 Fibrilacioni atrial AF	54
6.7 Crregullimet Mineralo-Kockore	60
6.8 Anemia dhe ESA (agjente stimulues të eritropoezës).....	62
6.9 Diabeti Mellitus	63
6.10 Hypoalbuminemia dhe malnutricioni	66
6.11 Nivelet e CRP	67
VII. Qëllimi i Studimit	68
VIII. METODOLOGJIA	68

IX. Analiza Statistikore	74
X. Rezultatet	76
XI. DISKUTIMI	93
11.1 Popullata në studim.....	94
11.2 Incidenca, prevalenca dhe mortaliteti	95
11.3 Faktorët e riskut	98
11.4 Moshë dhe gjinia.....	99
11.5 Hipertensioni.....	101
11.6 Ateroskleroza cerebro-vaskulare dhe përdorimi i medikamenteve që ulin LDL-kolesterolin.....	104
11.7 Fibrilacioni Atrial	106
11.8 Çrregullimet mineralo-kockore dhe trajtimi i tyre.....	107
11.9 Faktorët e lidhur me hemodializën	109
Vlerat e azotemisë, creatinemisë dhe adekuanca e seancës	109
11.10 Koha e eventit	111
11.11 Albuminemia	113
11.12 Aksesit vaskular	114
11.13 Anemia dhe Agjentët Stimulues të Eritropoezës	115
11.14 Analiza statistikore e faktorëve të riskut.....	116
11.15 Infarkti i heshtur i trurit, SCI	117
XII. Kufizimet e studimit:.....	119
XIII. Përfundime	120
XIV. Rekomandime	121
XV. BIBLIOGRAFIA	123


I-DEFINICIONI DHE KLASIFIKIMI I AKSIDENTEVE VASKULARE CEREBRALE

Megjithë rendesine, avancimet ne teknologji termi "stroke" nuk përcaktohet në mënyrë qendrueshme në praktikën klinike, në studime. Cdo studim apo vëzhgim I popullatave për stroke do të conte në perfundime shpesh here të gabuara nëse nuk nisen nga një perkufizim I standartizuar me kriteret e qarta. Përkufizimi klasik është kryesisht klinik dhe nuk merr parasysh avancimet në fushen e radiologjise. Këshilli i Stroke i Shoqatës Amerikane të Zemrës / Shoqata Amerikane e Stroke bën nje riformulim të stroke që është deri me sot me i ploti dhe që duhet të jete në bazë të të gjitha studimeve në mënyre që të ketë mundësi krahasimi midis tyre.

Në një percaktim te thjeshte stroke nenkupton nje deficit neurologjik qe vine nga nje demtim akut fokal i trurit si pasoje e nje demtimi vaskular dhe perfshin infarktine cerebral, hemorragjine intra cerebrale dhe hemorragjine arrachnoidale.(1)

Ne nje ndarje te thjeshte 3 grupet kryesore jane:

- stroke ishemik
- stroke hemorragjik
- TIA, Atak Ishemik Tranzistor



Tab 1. Klasifikimi nepermjet TOAST kriterëve

Stroke Data Bank	TOAST classification	Lausanne Stroke Registry	GÉNIC classification
<p>Atherothrombosis:</p> <ul style="list-style-type: none"> - >90% stenosis or occlusion on angiography of the internal carotid artery origin or siphon, BA, or major cerebral artery stem; - high convexity infarction on CT attributed to hemodynamic insufficiency if it was accompanied by an ipsilateral TIA within the previous 30 days; - ipsilateral bruit or prior TIA. <p>Tandem arterial pathology:</p> <ul style="list-style-type: none"> - extracranial lesion insufficient in itself to account for stroke on hemodynamic grounds, but possibly served as an embolic source; - supportive data: hemispherical surface infarct, relevant stenosis of >75%, single ulcer >2 mm in depth or multiple craters in the internal carotid artery, and >50% stenosis of any major cerebral artery stem or the BA. <p>Cardiac embolism:</p> <ul style="list-style-type: none"> - cardiac source recognized: AF or flutter, bacterial or marantic endocarditis, mitral annulus calcification, myocardial infarction within prior 6 weeks, atrial myxoma, mitral valve prolapse, right-to-left cardiac shunts, and pulmonary vein thromboses. 	<p>Large-artery atherosclerosis:</p> <ul style="list-style-type: none"> - >50% stenosis or occlusion of a major brain artery or branch cortical artery, presumably due to atherosclerosis (cortical or cerebellar dysfunction; no lacunar syndrome; cortical, cerebellar, brain stem or subcortical infarct >1.5 cm; stenosis of extracranial internal carotid artery; no other abnormalities on tests); - no cardiac source of embolism; - no subcortical or brainstem infarct <1.5 cm. <p>Cardioembolism:</p> <ul style="list-style-type: none"> - high-risk [mechanical prosthetic valve, mitral stenosis with AF, AF other than lone AF, left atrial/atrial appendage thrombus, sick sinus syndrome, recent myocardial infarction (<4 weeks), left ventricular thrombus, dilated cardiomyopathy, akinetic left ventricular segment, atrial myxoma, infective endocarditis]; - medium risk [mitral valve prolapse, mitral annulus calcification, mitral stenosis without AF, left atrial turbulence (smoke), atrial septal aneurysm, patent foramen ovale, atrial flutter, lone AF, bioprosthetic cardiac valve, nonbacterial thrombotic endocarditis, congestive heart failure, hypokinetic left ventricular segment, myocardial infarction >4 weeks and <6 months]. 	<p>Atherosclerosis with stenosis:</p> <ul style="list-style-type: none"> - >50% stenosis of corresponding extra- or intracranial artery (MCA, PCA, BA) in the absence of another cause. <p>Atherosclerosis without stenosis:</p> <ul style="list-style-type: none"> - plaques or <50% stenosis of corresponding extra- or intracranial artery (MCA, PCA, BA) in the absence of another cause; - and in patients with ≥ 2 of the following risk factors: age ≥ 50 years, hypertension, diabetes mellitus, cigarette smoking, or hypercholesterolemia. <p>Embolic heart disease:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Intracardiac thrombus or tumor, rheumatic mitral stenosis, prosthetic aortic or mitral valves, endocarditis, AF, sick sinus syndrome, left ventricular aneurysm or akinesia after myocardial infarct, acute (<3 months) myocardial infarct, or global cardiac hypokinesia or dyskinesia in the absence of another cause. 	<p>Atherothrombotic strokes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - defined by: (1) an ipsilateral internal carotid stenosis >30%, (2) an ipsilateral stenosis >50% of another intra- or extracranial artery, or (3) plaques >4 mm in the aortic arch with a mobile component. <p>Cardioembolic stroke:</p> <ul style="list-style-type: none"> - patients with mitral stenosis, myocardial infarction within the prior 3 weeks, mural thrombus in left cavities, left ventricular aneurysm, AF with or without spontaneous echocast or left atrial thrombus, endocarditis, intracardiac mass.
<p>Lacune:</p> <ul style="list-style-type: none"> - lacunar syndrome (pure motor, pure sensory, pure sensorimotor, pure hemiballism, pure hemichorea, ataxic hemiparesis, or dysarthria clumsy hand syndrome); - small, deep infarct found on CT or a normal CT scan 1 week following the stroke; - if angiography was performed it has to be normal. 	<p>Small vessel occlusion (lacune):</p> <ul style="list-style-type: none"> - one of the traditional clinical lacunar syndromes and no evidence of cerebral cortical dysfunction; - a history of diabetes or hypertension supports the diagnosis; - should have also a normal CT/MRI examination or a relevant brain stem or subcortical hemispheric lesion with a diameter of <1.5 cm; - should not fulfill criteria for large-artery atherosclerosis or cardioembolism (see above). 	<p>Hypertensive arteriopathy:</p> <ul style="list-style-type: none"> - infarction in the deep perforating artery in a patient with known hypertension in the absence of another cause. 	<p>Lacunar stroke:</p> <ul style="list-style-type: none"> - defined by a small deep infarct measuring <15 mm on MRI in the territory corresponding to the symptoms, in a patient presenting a clinical syndrome compatible with the diagnosis of lacune [12]; - with no finding to suggest an atherothrombotic or cardioembolic stroke.
<p>Unusual causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - arteritis, dissection, fibromuscular hyperplasia, sickle cell anemia; - stroke in the setting of migraine or mycotic aneurysm; - other diagnosed but rare or unusual forms of stroke. 	<p>Stroke of other determined cause:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nonatherosclerotic vasculopathies, hypercoagulable states, hematologic disorders; - cardiac source of embolism or large-artery atherosclerosis should be excluded. 	<p>Other causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - arterial dissection, fibromuscular dysplasia, saccular aneurysm, arteriovenous malformation, cerebral venous thrombosis on angiography, angitis (multiple segmental arterial narrowing on angiography, pleocytosis of cerebrospinal fluid), hematologic conditions (polycythemia, thrombocytopenia, etc.), migraine (history of migraine, occurrence of stroke during an attack of migraine), or other. 	<p>Arterial dissection:</p> <ul style="list-style-type: none"> - patients with typical clinical-angiographic patterns of carotid/vertebral artery dissection <p>Rare causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - patients who had rare causes (e.g. polycythemia vera, thrombocytopenia, lupus erythematosus).
-	<p>Stroke of undetermined cause:</p> <ul style="list-style-type: none"> - two or more causes identified; - negative evaluation; - incomplete evaluation. 	<p>Mixed causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - combinations of the above 4 subtypes. 	<p>Coexisting causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - when 2 or more causes coexist in the same individual.
<p>Infarction of undetermined cause:</p> <ul style="list-style-type: none"> - diagnosis of exclusion; - no bruit or TIA ipsilateral to the hemisphere affected by the stroke; - no obvious cardiac source of embolism (including occlusion without prior TIA and without a cardiac source of embolism) - normal CT or angiogram. 	-	<p>Undetermined cause:</p> <ul style="list-style-type: none"> - none of the above causes of cerebral infarction could be determined. 	<p>Unknown causes:</p> <ul style="list-style-type: none"> - patients who did not meet criteria for the groups as defined above. These patients may have incidental findings (isolated elevation of antiphospholipid antibodies, patent foramen ovale, atrial septal aneurysm, valvular strands, mitral valve prolapse, mitral annulus calcifications, plaques in the aortic arch without mobile component).
<p>Parenchymatous hemorrhage</p>	-	<p>Cerebral hemorrhage</p>	-
<p>Subarachnoid hemorrhage</p>	-	-	-

AF = Atrial fibrillation; BA = basilar artery; CT = computed tomography; GÉNIC = Étude du profil Génétique de l'Infarctus Cérébral; MCA = middle cerebral artery; MRI = magnetic resonance imaging; PCA = percutaneous coronary angiography; TIA = transient ischemic attack; TOAST = Trial of ORG 10172 in Acute Stroke Treatment.

Tabela 2. Ndarja e Stroke sipas llojeve dhe nentipet

<p>1. Ischemic</p> <p>1.1. Atherothrombotic</p> <p> 1.1.1. Extracranial</p> <p> 1.1.2. Intracranial</p> <p>1.2. Small vessel disease (sporadic)</p> <p>1.3. Cardiac emboli</p> <p>1.4. Other causes</p> <p> 1.4.1. Dissection</p> <p> 1.4.2. Rare or hereditary large- or medium-sized artery disease (e.g. moyo-moya disease, fibromuscular dysplasia)</p> <p> 1.4.3. Rare or hereditary small vessel disease</p> <p> 1.4.4. Coagulopathy</p> <p> 1.4.5. Metabolic disease with arteriopathy</p> <p> 1.4.6. Vasculitis</p> <p> 1.4.7. Other rare entities</p> <p>1.5. Coexisting causes</p> <p>1.6. Unknown</p> <p>1.7. Unclassifiable</p> <hr/>
<p>2. Hemorrhagic</p> <p>2.1. Hypertension-related small vessel disease (hemorrhagic type)</p> <p>2.2. Cerebral amyloid angiopathy</p> <p> 2.2.1. Sporadic</p> <p> 2.2.2. Hereditary</p> <p>2.3. Bleeding diathesis</p> <p> 2.3.1. Drugs that decrease clotting</p> <p> 2.3.2. Other hemostatic or hematologic disorders</p> <p>2.4. Vascular malformation</p> <p> 2.4.1. Arteriovenous malformation</p> <p> 2.4.2. Dural fistula</p> <p> 2.4.3. Ruptured aneurysm</p> <p> 2.4.4. Cavernoma</p> <p> 2.4.4.1. Sporadic</p> <p> 2.4.4.2. Familial</p> <p>2.5. Other causes</p> <p> 2.5.1. Tumor related</p> <p> 2.5.2. Toxic (e.g. sympathomimetic drugs, cocaine)</p> <p> 2.5.3. Trauma</p> <p> 2.5.4. Arteritis, angiitis, endocarditis (ruptured mycotic aneurysm), infections</p> <p> 2.5.5. Rare entities (e.g. dissection of intracranial arteries)</p> <p>2.6. Coexisting cause</p> <p>2.7. Unknown</p> <p>2.8. Unclassifiable</p> <hr/>
<p>3. Subarachnoid hemorrhage</p> <p>3.1. With aneurysm</p> <p>3.2. With dissection</p> <p>3.3. Traumatic</p> <p>3.4. Neoplastic (melanoma)</p> <p>3.5. Unknown</p> <hr/>
<p>4. Cerebral venous thrombosis</p> <hr/>
<p>5. Spinal cord stroke</p> <p>5.1. Ischemic</p> <p>5.2. Hemorrhagic</p> <p> 5.2.1. Associated with arteriovenous malformation</p> <p> 5.2.2. Associated with coagulopathy</p>

Stroke ishëmik i referohet posaçërisht infarkt të sistemit nervor qendror të shoqëruar nga simptoma të dukshme, ndërsa infarkti i heshtur sipas përkufizimit nuk shkakton simptoma të njohura (1).

Infarkti i sistemit nervor qendror përcaktohet si vdekje e trurit, palcës kurrizore ose qelizës retinale, që i atribuohet ishëmisë, bazuar në gjetjet neuropatologjike, radiologjike dhe / ose prova klinike të dëmtimit të përhershëm (1).

Stroke, gjithashtu përfshin hemorragjine intra-cerebrale dhe hemorragjine sub-arachnoidale.

Përkufizimi I perditesuar i stroke përfshin kritere klinike/ indore dhe duhet të përfshihet në praktikë dhe studime të ndryshme (2) me qëllim krahasimin e gjetjeve të tyre.

1.1 -Përkufizimi i infarkt të SNQ: infarkti i SNQ është vdekja e trurit, palcës kurrizore ose vdekja e qelizës retinale që i atribuohet ishëmisë, bazuar në:

1. Imazhe patologjike ose prova të tjera objektive të dëmtimit cerebral, palcës kurrizore, ose dëmtimit ishëmik fokal retinal në një shpërndarje të përcaktuar vaskulare; ose

2. Evidence klinike të dëmtimit ishëmik fokal cerebral, palcës kurrizore ose retinës bazuar në simptoma që vazhdojnë ≥ 24 orë ose deri në vdekje, dhe etiologji të tjera të përjashtuara. (1)

Përkufizimi i infarkt të SNQ duhet të jetë i kufizuar në indet e SNQ përfshirë trurin, palcën kurrizore dhe retinën.

Për shkak të ndryshimeve në mekanizmat e ishëmisë, trajtimit dhe shërimit midis ishëmisë së SNQ dhe Periferik NS, si dhe ndryshimeve strukturore dhe embrionologjike, përkufizimi i infarkt të SNQ duhet të kufizohet në tru, palcën kurrizore dhe retinën dhe duhet të përfshijë sindromat nervore kraniale të izoluara vetëm kur janë të pranishme prova të tjera konfirmuese të ishëmisë së sistemit të trurit (1).

Përkufizimi i infarkt të SNQ duhet të përfshijë situata neurologjike që vijnë si pasojë e ishëmisë fokale në SNQ dhe që mund të jenë atipike në prezantim.

Ishëmia e SNQ mund të mos manifestohet gjithmonë si shfaqje e papritur e simptomave neurologjike fokale. Simptomat atipike ose "somatike" (p.sh. dhimbje koke, lodhje, keqtrajtim) janë raportuar në 73% të grave dhe 65% të burrave që paraqesin simptoma akute në goditje, (37) duke sugjeruar që simptomat neurologjike fokale mund të mos jenë e vetmja shfaqje e infarkt të SNQ në shumë raste. Në disa kushte të rralla, zona të vogla të ishëmisë janë fillimisht asimptomatike por më vonë bëhen simptomatike pasi lezionet të shumta ishëmike grumbullohen.

(Shënim: infarkti i CNS përfshin infarkt hemorragjik, llojet I dhe II; shiko "Infarkt hemorragjik".)

1.2 -Përkufizimi i stroke ishemike: Një episod i mosfunksionimit neurologjik të shkaktuar nga infarkti fokal cerebral, spinal ose retinal. (1)

Përkufizimi i stroke ishemike duhet të jetë i kufizuar në isheminë fokale dhe të mos përfshijë isheminë globale.

Ekzistojnë disa arsye të cilat kufizojnë përkufizimin e stroke ishemike vetëm në isheminë fokale. Ekzistojnë dallime të rëndësishme në patologjinë dhe mekanizmat e ishemisë midis ishemisë fokale dhe globale.

Ishemia fokale ndodh brenda territorit të perfuzionit të një arterie e cila është e stenozyuar ose e bllokuar, dhe vdekja e qelizave lokalizohet në këtë rajon (1). Në isheminë fokale cerebrale, vdekja e qelizave është maksimale në fokusin ishemike dhe mund të shtrihet në penumbra, me të gjithë elementët qelizorë, përfshirë neuronet dhe qelizat mbështetëse të prekura.

Në të kundërt, ishemia globale rezulton nga ulja e perfuzionit cerebral si rezultat i uljes së presionit të gjakut (p.sh. në shok apo arrest kardiak) ose rritje të presionit intrakranial (p.sh. traumë e rëndë e kokës) (1). Në isheminë globale, humbja selektive neuronale duket se ndodh në zona të prekshme të hipokampusit, neokorteksit cerebral, talamusit, cerebellumit dhe ganglioneve bazale (36) dhe nuk është e izoluar me ndonjë shpërndarje të veçantë vasculare.

Të mbijetuarit e ishemisë globale (p.sh. pacientët që rikuperojnë pas arrestit kardiak) gjithmonë do të kenë ri-perfuzion të indit ishemik cerebral (36). Kjo rezulton në një arsye për dëmtim si pasojë e të efekteve patologjike të ri-perfuzionit në isheminë globale sesa në isheminë fokale.

1.3 -Përkufizimi i infarkt të heshtur të SNQ: Imazhe ose prova neuropatologjike të infarkt të SNQ, pa një histori të disfunksionit akut neurologjik që i atribuohet lezionit. (1)

1.4- Përkufizimi i hemorragjisë intracerebrale: Një koleksion fokal i gjakut brenda parenkimës së trurit ose sistemit të ventrikulit që nuk është shkaktuar nga trauma. Hemorragjia ndërqelizore përfshin hemorragji parenkimale pas infarkt të SNQ, llojet I dhe II (1)

Përkufizimi i stroke të shkaktuar nga hemorragjia intracerebrale: Zhvillimi i shpejtë i shenjave klinike të mosfunksionimit neurologjik, që i atribuohet një koleksioni fokal të gjakut brenda parenkimes së trurit ose sistemit të ventrikulit, i cili nuk është shkaktuar nga trauma. (1)

1.5- Përkufizimi i hemorragjisë cerebrale të heshtur: Një koleksion fokal i produkteve kronike të gjakut brenda parenkimës së trurit, hapësirës subarachnoid ose sistemit të ventrikulit në ekzaminimin radiologjik ose ekzaminim neuropatologjik, që nuk është shkaktuar nga trauma dhe pa një histori të mosfunksionimit akut neurologjik që i atribuohet lezionit. (1)

1.6- Përkufizimi i hemorragjisë subarachnoidale: Gjakderdhje në hapësirën subarachnoidale (hapësira midis membranës arachnoid dhe pia mater e trurit ose palcës kurrizore). (1)

Përcaktimi i stroke të shkaktuar nga hemoragjia subarachnoidale: Zhvillimi i shpejtë i shenjave të mosfunksionimit neurologjik dhe / ose dhimbje koke për shkak të gjakderdhjes në hapësirën subarachnoid (hapësira midis membranës arachnoid dhe pia mater e trurit ose palcës kurrizore), e cila nuk është shkaktuar nga trauma. (1)

1.7- Përkufizimi i stroke të shkaktuar nga tromboza venoze cerebrale: Infarkt ose hemorragji në tru, palcë kurrizore ose retinë për shkak të trombozës së një strukture venoze cerebrale. Simptomat ose shenjat e shkaktuara nga edemë e kthyeshme pa infarkt ose hemorragji nuk cilësohen si goditje. (1)

1.8- Përkufizimi i stroke që nuk specifikohet ndryshe: Një episod i mosfunksionimit neurologjik akut që supozohet të jetë shkaktuar nga ishemi ose hemorragji, që vazhdon 24 orë ose deri në vdekje, por pa prova të mjaftueshme për t'u klasifikuar si një nga më lart(1).

1.9- Përkufizimi i TIA (transient Ischemic Attack) që u përdor në raportin e vitit 1975 u citua në mënyrë universale deri në fillim të shekullit XXI, kur të dhënat e grumbulluara kërkonin një ripërcaktim. Këto të dhëna janë në 2 kategori: kohëzgjatja e TIA dhe gjetjet e imazhit. Të dhënat e reja nxorren polemika, që mbeten deri në ditët e sotme, në lidhje me ripërcaktimin e kohëzgjatjes së TIA dhe nevojën për përfshirjen e të dhënave të imazhit të trurit dhe ato vaskulare në përkufizim (3-4).

Në vitin 2002, një komitet ekspert propozoi një përkufizim të ri:

"Një TIA është një episod i shkurtër i mosfunksionimit neurologjik të shkaktuar nga ischemia fokale e trurit ose e retinës, me simptoma klinike që zakonisht zgjasin më pak se një orë, dhe pa dëshmi të infarktut akut". (3-4)

Në vitin 2009, një komitet ekspert i AHA / ASA publikoi një deklaratë shkencore që përcakton TIA dhe rekomandon vlerësimin. Përkufizimi i propozuar ishte:

“Atak ishemic kalimtar (TIA): një episod kalimtar i mosfunksionimit neurologjik të shkaktuar nga ischemia fokale e trurit, palcës kurrizore ose ischemia e retinës pa infarkt akut." (3-4)

II. INCIDENCA, PREVALENCA, MORTALITETI I STROKE DHE TIPET E TIJ NE POPULLATEN E GJERE

Shoqata Boterore e Stroke ka si sloganin e saj “1 in 4, DON’T BE THE ONE”. Dhe kjo fjali pershkruan me se miri shpeshesine dhe mundesine e prekjes nga stroke. Statistikat jane te shumta dhe te ndryshme ne vite me parashikime teper te larta per vitet ne vazhdim.

Rreth 180 M nerez jane duke jetuar me impaktin e stroke.

90% e gjithe stroke jane te lidhur me faktore te modifikueshem risku.

1 ne 4 nerez mbi 25 vjec do te perjetoj nje stroke ne jeten e tij...

Ne vit ka rreth 14 M ndodhi te reja te stroke

Cdo vit ka rreth 5.5 M vdekje nga stroke

116 M vite jete te shendetshme humbasin prej stroke cdo vit.

Ne nje raport epidemiologjik te publikuar nga World Stroke Organisation (Annual report 2020) parashikohet qe ne 2050 te kemi 200 M nerez te mbijetuar nga stroke , 106 M nerez me demence dhe cdo vit te jene: 30 M raste te reja, 12 M vdekje dhe 5 M vdekje nga demenca.

Organizata Botërore e Stroke përmbledh evidencat shkencore per te siguruar besueshmëri, risi ne te dhenat e stroke me impakt boteror.

Përdorimi I të dhënave të besueshme dhe të qëndrueshme per Stroke me qellim njohjen e natyrës së Stroke ndihmon ne ndertimin e pasqyrimit te nivelit te semundjes , per te vazhduar me tej me marjen e masave ne nivel global dhe nacional.

Te gjitha statistikat jane shqyrtuar dhe aprovuar për përdorim nga Komiteti Ekzekutiv I OBSH. Vlerat e meposhtëme janë përmbledhje e të dhënave të fundit te Stroke në të gjithë botën në vitin 2016 te publikuara nga World Stroke Organisation (5).

2.1 Te gjitha llojet e STROKE

➤ **Incidenca** e Stroke paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

Measure: Incidence	Number	Percent of total from all causes	Crude rate per 100,000 per year (UI)*	Age-adjusted rate per 100,000, per year (UI)	Approved Statement for use in WSO Materials
Ages (all), Sexes (both)	13,676,761	0.03	185.01 (171.98-198.75)	203.38 (189.24-218.16)	There are over 13.7 million new strokes each year*. Globally, one in four people over age 25 will have a stroke in their lifetime**
1-69 years	7,994,163	-	-	-	Almost 60% of all strokes each year are in people under the age of 70 years
1-44 years	111,0311	-			8% of all strokes each year are in people younger than 44 years
Men (all ages)	7,192,679	0.03	193.05 (179.24-207.31)	231.02 (214.69-248.15)	52% of all strokes each year occur in men
Women (all ages)	6,484,083	0.03	176.85 (164.32-190.01)	179.13 (166.23-192.47)	48% of all strokes each year occur in women

* V. Feigin et al. Global, regional, and national burden of stroke, 1990 to 2016: A systematic analysis for the Global Burden of Disease study 2016. The Lancet Neurology, 2019, forthcoming ** V. Feigin et al. Global, Regional, and Country-Specific Lifetime Risks of Stroke, 1990 and 2016. New Engl J Med 2018; 379:2429-2437

Ka mbi 13.7 milion goditje të reja çdo vit *. Në nivel global, një në katër persona mbi moshën 25 vjeç do të ketë goditje në jetën e tyre **

Pothuajse 60% e të gjitha goditjeve çdo vit janë tek njerëzit nën moshën 70 vjeç.

8% e të gjitha goditjeve çdo vit janë te njerëzit më të rinj se 44 vjeç.

52% e të gjitha goditjeve çdo vit ndodhin tek burrat.

48% e të gjitha goditjeve çdo vit ndodhin tek grate.

➤ **Prevalenca e Stroke** paraqitet në tabelën e mëposhtëme.

Measure: Prevalence	Number	Percent of total from all causes	Crude rate per 100,000 per year (UI)*	Age-adjusted rate per 100,000, per year (UI)	Approved Statement for use in WSO Materials
Ages (all), Sexes (both)	80,065,453	1.12	1,083.10 (1,002.23-1,167.80)	1,180.40 (1,093.20-1,273.43)	There are over 80 million people currently living who have experienced a stroke globally
1-69 years	49,693,284				60% of the people currently living who have experienced a stroke are under the age of 70
1-44 years	7,843,913				10% of the people currently living who have experienced a stroke are under the age of 44
Men (all ages)	38,968,949	1.10	1,045.89 (970.02-1,129.92)	1,232.57 (1,143.16-1,334.35)	49% of the people currently living who have experienced a stroke are men
Women (all ages)	41,096,505	1.15	1,120.90 (1,035.73-1,207.58)	1,136.08 (1,049.08-1,225.41)	Globally, women account for just over half (51%) of all persons who have experienced and survived a stroke

World Stroke Organisation 2016

Ka mbi 80 milion njerëz që jetojnë aktualisht dhe që kanë përjetuar një stroke, në nivel global.

60% e njerëzve që jetojnë aktualisht që kanë pësuar infarkt janë nën moshën 70 vjeç.

10% e njerëzve që jetojnë aktualisht që kanë pësuar infarkt janë nën moshën 44 vjeç.

49% e njerëzve që jetojnë aktualisht që kanë pësuar infarkt janë burra.

Në nivel global, gratë përbëjnë pak më shumë se gjysmën (51%) të të gjithë personave që kanë përjetuar dhe mbijetuar nga një goditje.

➤ **Vdekshmeria :**

1. Mortality and Disability-Adjusted Life Years (DALYs) for all Stroke Types Combined

Measure: Deaths	Number	Percent of total from all causes	Crude rate per 100,000 per year (UI)*	Age-adjusted rate per 100,000, per year (UI)	Approved Statement for use in WSO Materials
Ages (all), Sexes (both)	5,528,232	10.11	74.78 (72.16-77.58)	86.52 (83.34-89.92)	Five and a half-million people die from stroke annually.
1-69 years	2,135,159				39% of all deaths from stroke occur in people under 70 years old
1-44 years	230,025				4% of all deaths from stroke occur in people under 44 years old
Men (all ages)	2,931,769	9.77	78.69 (76.0- 81.30)	103.21 (99.44- 106.89)	53% of all deaths from stroke are in men
Women (all ages)	2,596,464	10.51	70.82 (67.00- 74.86)	72.49 (68.60- 76.54)	47% of all deaths from stroke are in women

World Stroke Organisation 2016

Pesë milion e gjysmë njerëz vdesin nga stroke në vit.

39% e të gjitha vdekjeve nga stroke janë te njerëzit nën 70 vjeç.

4% e të gjitha vdekjeve nga stroke janë te njerëzit nën 44 vjeç.

53% e të gjitha vdekjeve nga stroke janë te burrat.

47% e të gjitha vdekjeve nga stroke janë tek grate.

Mbi 116 milion vjet jetë të shëndetshme humbasin çdo vit për shkak të vdekjes dhe paaftësisë së lidhur me stroke.

2.2 STROKE ISHEMIK

➤ Incidenca:

Paraqiten rreth 9.5 milion raste të reja të strot-ut ishemic në vitin 2016

Rreth 60% e të gjitha rasteve të reja të Stroke ishemic shfaqet në njerezit nën 70-vjeç.

7% e rasteve të reja me stroke ishemic shfaqet në njerezit nën 44-vjeç.

52% e rasteve të reja të Strokut ishemic janë të meshkujt.

48% e rasteve të reja të Strokut ishemic shfaqet te femrat.

➤ Prevalenca :

Ka mbi 67.5 milion njerëz që jetojnë aktualisht që kanë përjetuar një stroke ishemic.

61% e njerëzve që kanë pësuar strot ishemic dhe që jetojnë aktualisht, janë nën moshën 70 vjeç.

10% e njerëzve që kanë pësuar strot ishemic dhe jetojnë aktualisht janë nën moshën 44 vjeç.

49% e njerëzve që kanë pësuar strot ishemic dhe jetojnë aktualisht janë burra.

Në nivel global, gratë përbëjnë pak më shumë se gjysmën (51%) të të gjithë personave që kanë përjetuar dhe mbijetuar nga një stroke.

➤ Vdekshmeria:

2.7 milion njerëz vdesin nga stroke ishemic në vit.

1/4 e të gjitha vdekjeve nga stroke ishemic janë te njerezit nën 70 vjeç.

1% e të gjitha vdekjeve nga stroke ishemic janë te njerezit nën 44 vjeç.

49% e të gjitha vdekjeve nga stroke ishemic janë te burrat.

Cdo vit me shume se gjysma e vdekjeve te stroke ndodhin tek femrat, 51 % e vdekjeve nga stroke ishemic ndodhin tek grate.

2.3 STROKE HEMORRAGJIK (Hemorragjia e kombinuar araknoidale dhe intracerebrale)

➤ Incidenca :

Paraqiten rreth 4.1 milion raste te reja te stroke hemorragjik ne vitin 2016.

Rreth 60% e te gjitha rasteve te reja te Stroke hemorragjik shfaqet ne njerezit nen 70-vjec.

10% e rasteve te reja me stroke hemorragjik shfaqet ne njerezit nen 44-vjec.

53% e rasteve të reja të Stroke hemorragjik jane te meshkujt.

47% e rasteve të reja te Stroke hemorragjik shfaqet te femrat.

➤ Prevalenca :

Ka mbi 15 milion njerëz që jetojnë aktualisht që kanë përjetuar stroke hemorragjik.

67% e njerëzve që kanë pësuar stroke hemorragjik dhe kane mbijetuar janë nën moshën 70 vjeç.

15% e njerëzve që kanë pësuar stroke hemorragjik dhe jetojne janë nën moshën 44 vjeç.

49% e njerëzve që kanë pësuar stroke hemorragjik dhe jetojne janë burra.

Në nivel global, gratë përbëjnë pak më shumë se gjysmën (51%) të të gjithë personave që kanë përjetuar dhe mbijetuar nga stoku hemorragjik.

➤ **Vdekshmeria:**


Gjysma e vdekjeve 51% nga stroke I atribuohet stroke hemorragjik.

50% e të gjitha vdekjeve nga stroku hemorragjik janë te persona nën 70 vjeç.

7% e të gjitha vdekjeve nga stroku hemorragjik janë te persona nën 44 vjeç.

56% e të gjitha vdekjeve nga stroku hemorragjik janë te burrat.

44% e të gjitha vdekjeve nga stroku hemorragjik janë te grate.



	23	CENTRAL AFRICA	130.19		84	CAPE VERDE	76.93		145	SLOVENIA	35.52
	24	NO MACEDONIA	129.86		85	IRAQ	75.79		146	ARGENTINA	33.60
	25	MALI	129.28		86	BELIZE	74.94		147	NICARAGUA	33.43
	26	MOLDOVA	127.15		87	ETHIOPIA	74.87		148	LEBANON	32.84
	27	MADAGASCAR	123.94		88	JORDAN	74.71		149	SOUTH KOREA	32.37
	28	BULGARIA	121.37		89	SERBIA	74.56		150	HONDURAS	30.93
	29	ALBANIA	120.28		90	LITHUANIA	73.02		151	PERU	30.61
	30	KAZAKHSTAN	120.09		91	INDIA	71.76		152	MEXICO	30.61
	31	CHAD	119.29		92	ARAB EMIRATES	71.51		153	ESTONIA	29.70
	32	GUINEA-BISSAU	117.75		93	SAMOA	71.26		154	MALTA	29.20
	33	KIRIBATI	116.92		94	TRINIDAD/TOB.	70.31		155	COSTA RICA	28.83
	34	CHINA	116.88		95	GABON	68.90		156	CYPRUS	27.77

ICD-10 CODES: I60-I69

Data rounded. Decimals affect ranking.

Data Source: WORLD HEALTH ORGANIZATION 2018

Fig 1. Harta e vdekshmerise se stroke per 100.000 persona e publikuar nga World Health me te dhena nga ICD-CODEs 160-169

2.4 Situata ne Shqipëri

Duke ju referaur të dhënave të INSTAT për Sëmundjet cerebro-vaskulare dhe STROKE, AVC për vitin 2015-2018 paraqiten shifra si mëposhtë:

Sëmundjet Cerebro-Vaskulare

Grup-mosha	2015	2016	2017	2018
1-4 vjec	1	1		Nën 1 vjec dhe 5-9 vjec 4 raste
10-14 vjec	2	1	2	
15-19 vjec	4	2	4	1
20-24 vjec	4	1	2	6
25-29 vjec	2	4	3	3
30-34 vjec	7	5	3	6
35-39 vjec	8	11	8	9
40-44 vjec	18	17	11	16
45-49 vjec	56	34	44	22
50-54 vjec	76	59	77	58
55-59 vjec	117	132	148	130
60-64 vjec	205	145	227	169
65-69 vjec	252	206	262	259
70-74 vjec	426	290	367	311
75-79 vjec	628	448	558	550
80-84 vjec	615	534	590	607
Mbi 84	722	596	684	668
Total	3143	2486	2990	2819

Nisur nga të dhënat e INSTAT për sëmundjet cerebrovaskulare nga viti 2015 deri në vitin 2018 vëmë re që numri i rasteve ka ardhur në rritje, grup-moshat më të prekura janë mbi 70 vjec po kjo nuk përjashtohen dhe grup-moshat e tjera edhe pse në numër të vogël.

Gjinia më e prekur është gjinia mashkullore për vitin 2015 tek mashkujt rastet e prekur nga sëmundjet cerebrovaskulare janë 1709 ndërsa tek femrat 1434.

Në vitin 2016 tek femrat 1135 dhe tek meshkujt 1351 raste me sëmundje cerebrovaskulare dhe në vitin 2017, 1337 raste tek femrat dhe 1653 raste cerebrovaskulare te meshkujt.

Për vitin 2018 ndarja sipas grup-moshës për të prekurit me sëmundje cerebrovaskulare është e ndryshme nga tre vitet e para, por sërisht rastet me sëmundje cerebrovaskulare janë më të përhapura në grup-moshat mbi 70 vjec por në total janë më pak krahasuar me vitin 2017 dhe më shumë se viti 2015 dhe 2016. Gjinia mashkullore është më e prekur në 1537 raste krahasuar me gjininë femërore në 1282 raste cerebrovaskulare.

Raste me STROKE /AVC në popullatën e përgjithshme

Grup-mosha	2015	2016	2017	2018
1-4 vjec	2	Nën 1 vjec 2 raste		Nën 1 vjec 1 rast
5-9 vjec	1		1	
10-14 vjec	3	2	1	1
15-19 vjec	7	1	1	
20-24 vjec	12	5		2
25-29 vjec	14		1	
30-34 vjec	21	4	1	
35-39 vjec	48	7	5	5
40-44 vjec	87	2	13	7
45-49 vjec	136	25	18	11
50-54 vjec	263	31	29	31
55-59 vjec	317	80	82	60
60-64 vjec	454	121	129	138
65-69 vjec	536	219	236	194
70-74 vjec	602	410	426	372
75-79 vjec	565	836	779	791
80-84 vjec	410	989	1027	985
Mbi 84	204	1039	1101	1085
Total	3682	3773	3849	3683

Rastet me STROKE / AVC në popullatën e përgjithshme kanë ardhur në rritje numri më i lartë nga të dhënat e INSTAT vihet re për vitin 2017 me 3849.

Grup-moshat ku numri i goditjeve vjen duke u rritur janë ato mbi 60 vjec. Por në ndryshim nga sëmundjet cererovaskulare tek goditjet numri me i larte është tek femrat krahasur me meshkujt me përjashtim të vitit 2015 ku raporti ndryshin kështu ndër vite ka qënë:

Në vitin 2015 nga totali prej 3682, 1364 femra:2318 meshkuj.

Në vitin 2016 nga totali prej 3773, 2056 femra:1717 meshkuj.

Në vitin 2017 nga totali prej 3849, 2155 femra:1694 meshkuj

Në vitin 2018 nga totali prej 3683, 2039 femra:1644 meshkuj

Situata ne Shqiperi persa i perket vdekjeve me etiologji SRK.

Ne nxorrem nga te dhenat e INSTAT vdekjet me kodin 585 dhe rezultatet ishin:

Ne vitin 2016 nga totali prej 240 vdekje per shkaqe renale 189 ishin per arsye te SRK.

Ne vitin 2017 nga totali prej 234 vdekje per shkaqe renale 181 ishin per arsye te SRK.

Ne vitin 2018 nga totali prej 248 vdekje per shkaqe renale 181 ishin per arsye te SRK.

Nuk mundem te gjenim te dhena per vdekjet nga stroke/AVC tek pacientet me SRK apo ne hemodialize.

III-INCIDENCA PREVALENCA MORTALITETI I STROKE NE ESRD DHE DIALIZE NE BOTE

Pacientët me ESRD në dializë kane nje risk më të larte per stroke, me norma që ndryshojnë nga 10 në 33 për 1.000 pacientë [6-7-8-9-10]. Meshkujt afrikano-amerikanë me ESRD kane një risk të veçantë në krahasim me popullsinë e përgjithshme krahasuar me meshkujt evropianë amerikanë [6]. Një studim retrospektiv 7-vjeçar nga Power et al. (8) raportoi se goditja e parë ndodh në një normë prej 14.9 / 1000 pacientë-vit tek ata me ESRD. Megjithëse kishte një mbizotërim të goditjeve ishemike (përkundrejt nëntipit hemorragjik), pacientët me përkatësi etnike të Azisë Jugore ishin më të prirur ndaj goditjeve hemorragjike [8].

Fillimi i dializës në vetvete shoqërohet me një rrezik të shtuar të goditjes në tru, mbi rrezikun e rritur të përgjithshëm që shihet te pacientët prevalent te ESRD [8-9-10]. Në një studim retrospektiv 22-vjeçar ne një qendër të vetme, 39% e stroke ishemike dhe 35% e stroke hemorragjike kanë ndodhur gjatë ose menjëherë pas një seance hemodializë [11].

Një studim i bazuar në popullatë të pacientëve të moshuar me dializë amerikane raportoi se, pavarësisht nga modaliteti i dializës, përqindja e ndodhise se stroke fillon të rritet afërsisht 3 muaj para fillimit të trajtimit me hemodializë dhe arrin kulmin gjatë 30 ditëve të para pas fillimit të dializës [13].

Pacientët në fazën 3–5 SRK (të përcaktuara si një GFR të vlerësuar <60 ml / min për 1.73 m²) kanë një risk më të lartë për stroke në krahasim me pacientët që nuk kanë SRK (12) ky risk rritet akoma më shumë gjatë vitit të parë pas fillimit të hemodializës (14). Periudha e tranzicionit që fillon 1 vit para dhe mbaron 1 vit pas fillimit të hemodializës mbart në një shkallë më të lartë me ritme të përshejtuara rezultate të njohura si probleme kardiovaskulare dhe vdekshmëri, dhe përfshin dhe incidence më të lartë të strotut (15-16). 90 ditët e para pas fillimit janë veçanërisht në një risk shumë të lartë, sepse shkalla e sëmundjeve kardiovaskulare dhe e vdekshmërisë mund të rritet me më tepër se 50% (17). Sidoqoftë, ka pasur relativisht pak studime epidemiologjike rreth stroke gjatë kësaj periudhe tranzicioni, krahasuar me studimet e nderlikimeve të tjera kardiovaskulare.


Në një studim të incidencës së stroke përpara dhe pas fillimit të dializës nga Murray A. et al u pa se tek pacientët jo të hospitalizuar përpara fillimit të hemodializës, shkalla e incidencës së stroke ishte rreth 0.15% tek pacientët për një muaj (ppm), ose afërsisht 2.4% e pacientëve për një vit (ppm), deri në 6 muaj para fillimit, kur normat e pacientëve rriten me 0.2% [13]. Duke vazhduar tek 3 muajt para fillimit, mundësia e stroke rritet në 0.3% ppm, vazhdon të rritet në 0.5% ppm në 0-30 ditët e para, dhe arrin kulmin në 0.7% ppm (8.4% ppm) në 30 ditët e para pas fillimit, me shumë se 4 herë krahasuar me shkallën fillestare (P <0.0001) [13]. Shkalla e stroke më pas luhet disi, por mbetet më e lartë se nivelet e paramenduara, midis 0.3% dhe 0.5% ppm, për një vit të plotë pas fillimit; përqindja në 12 muaj bëhet sa dyfishi i nivelit fillestar, në 0,32% ppm(13)

Për pacientët e hospitalizuar gjatë fillimit të hemodializës, nivelet e incidencës për një stroke fillestar janë të ngjashme me përqindjet për pacientët ambulator, me rreth 0.20% ppm (13) normat rriten me 0.3% –0.5% ppm brenda 90 ditëve të para të fillimit, dhe vazhdojnë të rriten në 1.5% ppm (18% ppy), 7 herë më shumë se niveli fillestar i para caktuar (P <0.0001), gjatë qëndrimit në spital për të filluar hemodializën. Pas fillimit, normat të cilat janë 0.7% –0.8% ppm për rreth 120 ditë, shkojnë në 0.4% ppm (4,8% ppy), rreth dyfishi i nivelit të paramenduar për një vit të plotë (13).

Në përgjithësi, shkalla e pikës së stroke gjatë muajit të fillimit të hemodializës ishte afërsisht dy herë më e lartë në mesin e pacientëve spitalorë krahasuar me pacientët ambulantë (1.5% ppm dhe 18% ppy kundrejt 0.7% ppm dhe 8.4% ppy), dhe normat mbesin rreth 30% më të larta pas fillimit(13).


Te gjitha studimet për incidence e stroke treguan se ajo fillon të rritet rreth 3 muaj para fillimit të dializës dhe arrin kulmin gjatë muajit të fillimit të hemodializës (12).

Sipas Murray A. et al incidenca rritet 4 herë më tepër se niveli fillestar në pacientët ambulator dhe 7 herë më tepër se niveli fillestar tek pacientët spitalorë (13). Në të dy grupet, perqindja e stroke bie me shpejtësi në 1 deri në 2 muaj pas fillimit, vlerat më pas luhaten dhe gradualisht stabilizohen në afërsisht dyfishin e nivelit fillestar pas nje viti nga fillimi i stroke. Shkalla kulmore e stroke gjatë muajit të fillimit eshte afërsisht dy herë më e lartë për pacientët ambulator krahasuar me pacientët spitalorë dhe shkalla e goditjes është rreth 30% më e lartë për pacientët spitalorë pas fillimit të stroke (13).




Incident stroke/transient ischemic attack rates for incident hemodialysis patients in 2009 who initiated hemodialysis as outpatients J Am Soc Nephrol. 2013 Jun 28; 24(7): 1166–1173.

Figura 2. Incidenca e stroke tek pacientet qe filluan HD si ambulator



Incident stroke/transient ischemic attack rates for incident hemodialysis patients in 2009 who initiated hemodialysis as inpatients. J Am Soc Nephrol. 2013 Jun 28; 24(7): 1166–1173.

Figura 3. Incidence e stroke tek pacientet qe filluan HD te hospitalizuar



The pattern for rates of all strokes was similar to the pattern for outpatient and inpatient incident strokes J Am Soc Nephrol. 2013 Jun 28; 24(7): 1166–1173.

Figura 4. Incidence e stroke per te gjithë pacientet pre dhe post fillimit te HD

Tabele 3. Studimet e publikuara mbi stroke ne ESRD-dialize

Published observational data on stroke in selected and unselected dialysis populations

Author (reference) (acronym)	Year	Study design	Location (population)	Ethnicity	Stroke number	Population size/type	Mean Age (years)	Crude incidence (% p.a)	% Ischemic	Case fatality	Independent stroke predictors
Kawamra	1971–1994	R	Miyazaki, Japan	Japanese 100%	80 [#]	4064 HD	54	1.2	30	I: 50% H: 71%	–
Kuo	1999–2008	R	Taiwan	Chinese 100%	119	644 HD	54	4.2	80	–	–
Seliger	1993–1998	R	US	Mainly African Americans and Caucasians	32,151 [#]	436000 HD+PD	72	3.2–5.9	–	–	–

Author (reference) (acronym)	Year	Study design	Location (population)	Ethnicity	Stroke number	Population size/type	Mean Age (years)	Crude incidence (% p.a)	% Ischemic	Case fatality	Independent stroke predictors
Seliger	1993–1999	R	US	White 53% Black 40% Asian/other 7%	915 ^a	8920 HD+PD	60	3.3 ^a	84	–	Older age; high mean predialysis blood pressure; lower serum albumin; considered undernourished
Toyoda	1980–2002	R	Fukuoka, Japan	Japanese 100%	144	1740 HD	62	1.2	60	I: 6% H: 50%	–
Shah	1998–2007	R	Canada (with AF)	–	107	1626 HD+PD	75	3.1	–	–	–
Chan	2003–2007	R	US (with AF)	White 80% ^f Black 14% Other 6%	102 ^a	1671 HD	73	4.8 ^c	82	–	Warfarin prescription; higher CHADS2 score
Olesen	1997–2008	R	Denmark (with AF)	–	164 ^e	901 RRT	67	5.6	–	–	Older age; prior stroke; no warfarin prescription
Power	2002–2009	R	London, England	White 42% Black 18% S.Asian 34% Other 5%	121	2474 HD	58	1.7	71	I: 7% H: 32%	Diabetes; prior cerebrovascular disease
Wang	1998–2009	R	Taiwan	Chinese 100%	2424	79,986 HD+PD	52	1.7	58	–	Older age; diabetes; hypertension; anemia
Iseki	1988–1998	P	Okinawa, Japan	Japanese 100%	259 ^a	3741 HD+PD	53	1.7	37	–	Hypertension
Winkelayer	1994–2006	P	US (≥65 years+AF) ^d	White 67% ^d	188	1185 HD	–	9.5 ^d	84 ^{a,d}	–	–
Wizeman (DOPPS)	1994–2004	P	Worldwide (with AF)	–	148	3250 HD	–	3.4	–	–	Atrial fibrillation

Author (reference) (acronym)	Year	Study design	Location (population)	Ethnicity	Stroke number	Population size/type	Mean Age (years)	Crude incidence (% p.a)	% Ischemic	Case fatality	Independent stroke predictors
Sozio (CHOICE)	1995–2004	P	US	White 67% Black 28% Other 5%	176	1041 HD+PD	58	4.3	87	I: 28% H: 90%	Older age; white race; diabetes; coexistent diseases
Tripepi (CREED)	1997–2007	P	Southern Italy	–	47	283 HD+PD	61	3.9 ^f	85 ^f	I: 52% H: 33% ^f	Smoking; higher pulse pressure; higher hemoglobin; older age; higher triglycerides; higher left ventricular mass
Sanchez-Perales	1999–2008	P	Jaen, Spain	–	34	449 HD+PD	64	2.4 ^b	–	I: 35%	Older age; atrial fibrillation; diabetes
Shoji	2003–2004	P	Japan	Japanese 100% ^f	1592	45,390 HD	62	3.5	70	I: 8% H: 27%	Lower albumin; male sex; diabetes; higher non-HDL-C; higher CRP; low BMI; older age
Delmez (HEMO)	1995–2000	RCT	US	White/Other 37% Black 63%	63 stroke deaths	1846 HD	58	1.2	73	–	Low albumin; diabetes; higher hemocrit; low BMI
Wanner (4D)	1998–2002	RCT	Germany (type 2 diabetes)	Predominately White	103	1225 HD	66	2.1 ^f	87	–	Nonsinus rhythm
Fellström (AURORA)	2003–2009	RCT	Worldwide	White 85% Black 4% Asian 5% Other 6%	164	2776 HD	64	1.8 ^f	71	I: 32% H: 70%	–

p.a., per annum; R, retrospective; P, prospective; RCT, randomized control trial; AF, atrial fibrillation; HD, hemodialysis; PD, peritoneal dialysis; RRT, renal replacement therapy; US, United States; I, ischemic; H, hemorrhagic; BMI, body mass index; HDL-C, high-density lipoprotein cholesterol; CRP, C-reactive protein; USRDS, United States Renal Data System; DOPPS, Dialysis Outcomes and Practice Patterns Study; CHOICE, Choices For Healthy Outcomes in Caring for ESRD; CREED, Cardiovascular Risk Extended Evaluation in Dialysis patients; HEMO, Hemodialysis study; 4D, Die Deutsche Diabetes Dialyse Studie; AURORA, A study to evaluate the Use of Rosuvastatin in subjects On Regular hemodialysis: an Assessment of survival and cardiovascular events. ^aMay include subarachnoid hemorrhage. ^bIschemic stroke only. ^cIncludes transient ischemic attacks. ^dData limited to propensity matched cohort. ^eIncludes stroke and other systemic thromboembolism. ^fEstimated. ^gAge-standardized incidence.

Ne nje studim kohort te Wetmore J et al , per lidhjen midis stroke dhe vdekshmerise tek pacientet ne dialize u pa se ne nje grup prej 112.801 persona te vezhguar per një kohë mesatare të ndjekjes prej 1.24 vjet një total prej 2381 individësh ,patën një stroke ishemike gjatë ndjekjes, me 21.1 stroke ishemike për 1000 pacientë-vjet; 62.9% e individëve me stroke ishemike vdiqën, krahasuar me 38.2% të personave pa stroke (P <0.001). Një total prej 534 individësh patën një stroke hemorragjike gjatë ndjekjes, me 4.7 stroke hemorragjike për 1000 pacientë-vjet. Nga ata me stroke hemorragjike, 76.6% vdiqën (P <0.001 krahasuar me pa stroke)[18].

<i>Akses vascular</i>	FAV fistul	21 (30.0)	52 (75.4)	73 (52.5)	<0.001
	CVC cateter	49 (70.0)	17 (24.6)	66 (47.5)	

*Hi-katror

Po ashtu nuk gjendet diference statistikisht e rëndesishme mes grupeve lidhur me përdorimin e antikoagulantëve ($p=0.207$), ndërkohë që ka një diferencë të rëndesishme mes grupeve lidhur me aksesin vaskular ($p<0.001$), kurse në grupin e studimit dominojnë rastet me CVC, kateter (70.0%).




Grafiku 5. Ndarja sipas antikoagulantëve të përdorur gjatë seances së dializes



Grafiku 6. Ndarja sipas llojit te aksesit vaskular


Variablet	Grupet		Vlera p
	gr studim	gr controllit	
mosha	57.57+12.44	53.32+13.49	0.057
Koha ne dialize	27.20+31.07	116.34+20.38	<0.001
azot	159.66+44.29	140.65+27.45	0.003
creat	9.14+2.27	10.49+2.23	0.001
URR	64.78+10.39	67.93+7.48	0.042
KTV	1.49+0.37	1.50+0.25	0.852
calcium	8.52+0.74	8.74+0.75	0.081
Ca I jonizuar	1.15+0.15	1.22+0.12	0.004
fosfor	5.34+1.93	5.69+1.57	0.235
kalemi	6.01+0.99	5.93+0.67	0.582
UF	3.29+0.80	3.50+0.57	0.076
HbA1C	6.03+1.33	5.38+0.89	0.016
cholesterol	201.75+62.61	164.75+35.20	<0.001
HgB	9.32+1.75	10.99+1.63	<0.001
vitD	16.26+7.75	26.82+16.41	0.01
PTH	625.50+815.14	765.11+554.30	0.241
albumine	3.69+0.62	4.15+0.43	<0.001
proteine	6.43+0.71	7.14+0.60	<0.001

*testi I Studentit




Grafiku 7. Koha mesatare ne dialize, sipas grupeve

Koha mesatare ne dialize ishte 27.20 +31.07 tek grupi I stroke dhe 116.34+20.38 tek grupi I kontrollit me nje vlere te $p < 0.001$.




Grafiku 8 .Vlera mesatare e azotemise, sipas grupeve

Vlerat e azotemise ishin 159.66 +44.29 tek grupi I stroke dhe ne vlerat 140.65+27.45 tek grupi i kontrollit, me nje vlere te $p 0.003$.




Grafiku 9 .Vlera mesatare e creatinemise, sipas grupeve

Vlerat mesatare te creatinemise ishin $9.14 + 2.27$ tek grupi I stroke dhe $10.49 + 2.23$ tek grupi I kontrollit me nje vlere te $p < 0.001$.




Grafiku 10 .Vlera mesatare e hemoglobines, sipas grupeve

Vlerat e Hgb ishin $9.32 + 1.75$ tek grupi I stroke dhe $10.99 + 1.63$ tek grupi I kontrollit me nje vlere te $p < 0.001$.




Grafiku 11 .Vlera mesatare e URR, sipas grupeve

URR ishte $64.78+10.39$ tek grupi ne studim dhe ne vlerat $67.93+7.48$ tek grupi I kontrollit me nje vlere te $p 0.042$.




Grafiku 12 .Vlera mesatare e Ca^{++} te jonizuar, sipas grupeve

Ca I jonizuar ishte $1.15 +0.15$ ne grupin e stroke dhe $1.22+0.12$ ne grupin e kontrollit me nje vlere te $p 0.004$.




Grafiku 13 .Vlera mesatare e HbA1c, sipas grupeve

HbA1C ne grupin e stroke ishte $6.03+1.33$ dhe $5.38+0.89$ ne grupin e kontrollit dhe p rezultoi 0.016.



Grafiku 14 .Vlera mesatare e kolesterolit, sipas grupeve


Vlerat e kolesterolit ishin $201.75+62.61$ ne grupin e stroke dhe $164.75+35.20$ ne grupin e kontrollit, $p<0.001$.



Grafiku 15 .Vlera mesatare e vitamines D, sipas grupeve


Pamvaresisht se duket sikur ka nje luhatje te vlerave te Vit D ne analizen e kryer

P rezultoi 0.01 dhe kjo diference u cilesua e parendesishme statistikisht.



Grafiku 16 .Vlera mesatare e albumines, sipas grupeve

Sic shihet dhe nga grafiku 16, vlera e albumines ishte nje faktor I rendesishem per AVC. Ato ishin ne vlerat 3.69 ± 0.62 ne grupin e stroke dhe ne vlerat 4.15 ± 0.43 ne grupin e kontrollit , $p < 0.001$, cka perben nje ndryshim statistikisht te rendesishem.



Grafiku 17 .Vlera mesatare e proteines, sipas grupeve

Vlerat e proteines ishin 6.43 ± 0.71 ne grupin e stroke dhe 7.14 ± 0.60 ne grupin e kontrollit , me $p < 0.001$

Grupi në studim

74.3% kane bere AVC ischemic dhe 25.7% kane bere AVC hemorragjik

Gjinia	Lloji AVC		Total n=70 (%)
	Ischemic n=52 (%)*	Hemorra gjik n=18 (%)	
m	27 (51.9)	10 (55.6)	37 (52.9)
f	25 (48.1)	8 (44.4)	33 (47.1)

*perqindjet jane llogaritur ne kolona

Nuk ka diference ne gjini lidhur me llojin e AVC-se ($p=0.504$). Gjinia ne grupin tone ishte nje faktor i parendesishem per AVC.

Ne literature cilesohet se vlerat e uleta te fosforit mund te jene nje factor risk per AVC ischemic tek femrat, por jo tek meshkujt (Q-cohort study). Per kete analizuam lidhjen e llojit te AVC me nivelet e fosforit sipas gjinise dhe ne fakt rezulton se femrat me AVC ischemic kane nivelin mesatar te fosforit ($4.42+1.45$) sinjifikativisht ($p=0.048$) me te ulet sesa mesatarja e vlerave te fosforit tek femrat me AVC hemorragjik ($5.36+1.45$).

Gjinia	lloji AVC	Nr I rasteve	Mesatare e fosforit ne kohen e ndiodhjes se eventit	Vlera p
m	ischemic	27	$5.93+1.87$	0.152
	hemorragjik	10	$6.02+2.72$	
f	ischemic	25	$4.42+1.45$	0.048
	hemorragjik	8	$5.36+1.45$	

Analiza univariate mes AVC (po vs jo) dhe variableve: azotemi, URR, fosfor, HbA1C, HgB, albumine, akses vascular (Cateter vs FAV), HTA (po vs jo), ritmi (FA vs ritem sinusal), kolesterol.

Nga kjo analize (duke axhustuar per moshen) rezultoi se:

Per çdo ulje te albumines me 1gr, rriten 18 here gjasat per te bere AVC [OD=18.29; CI95%: 3.11-27.25],

Pacientet me kateter kane 9 here me shume gjasa se ata me FAV per te bere AVC [OD=9.7; CI95%: 6.72-14.67],

Pacientet me hipertonic kane 4 here me shume gjasa se ata me TA normal per te bere AVC [OD=4.0; CI95%: 1.98-6.28]

		B	S.E.	Wald	df	Sig.	Exp(B)	95% C.I.for EXP(B)	
								Lower	Upper
Step 1 ^a	akses_vascular(1)	-2.277	.545	17.473	1	.000	6.103	1.535	10.298
	Constant	1.099	.365	9.052	1	.003	3.000		
Step 2 ^b	akses_vascular(1)	-2.155	.623	11.945	1	.001	.116	.034	.393
	HTA_cod(1)	-3.310	1.120	8.732	1	.003	5.37	2.004	7.328
	Constant	3.772	1.134	11.067	1	.001	43.451		
Step 3 ^c	albumine	2.906	.903	10.369	1	.001	18.288	3.118	27.251
	akses_vascular(1)	-2.279	.774	8.665	1	.003	.102	.022	.467
	HTA_cod(1)	-3.671	1.223	9.003	1	.003	4.00	1.981	6.280
	Constant	-7.675	3.551	4.671	1	.031	.000		

a. Variable(s) entered on step 1: akses_vascular.

b. Variable(s) entered on step 2: HTA_cod.


c. Variable(s) entered on step 3: albumine.

Mbijetesa

Vdekshmeria	Grupet		Total	Vlera p*
	Gr studim	Gr controllit		
vdekur	58 (82.9)	14 (20.0)	72 (51.4)	<0.001
gjalle	12 (17.1)	56 (80.0)	68 (48.6)	

Analiza e mbijeteses

gr studim	Total N	nr I vdekjeve	Koha mesatare ne dialize	CI95%		Koha mediane	CI95%	
gr studim	70	58 (82.85)	36.49	24.97	48.01	17.00	9.69	24.31
gr controllit	70	14 (20.00)	132.56	131.79	133.32	.	.	.
Totali	140	72 (51.43)	88.75	78.47	99.05	133.00	126.82	139.18



Grafiku 18. Mbijetesa e grupeve ne studim


gr studim	Total N	nr I vdekjeve	Koha mesatare e eventit	CI95%		Koha mediane	CI95%	
ishemic	52	41 (78.85)	37.35	22.98	51.70	20.00	12.25	27.75
hemorragjik	18	17 (94.44)	23.72	11.68	35.77	11.00	2.68	19.32
Totali	70	58 (82.86)	32.44	21.68	43.19	17.00	7.95	26.05

Koha mesatare e eventit=koha nga fillimi i HD deri ne ndodhine “AVC”.

Overall Comparisons

grupet	Chi-Square	df	Sig.
gr studim Log Rank (Mantel-Cox)	.505	1	.477

Test of equality of survival distributions for the different levels of lloji_I_avc.



Grafiku 19. Mbijetesa ne grupin ne studim sipas llojit te eventit te ndodhur.

XI. DISKUTIMI

Stroke përfaqëson një grup çrregullimesh neurologjike të cilat ndeshen shpesh tek pacientet me sëmundje renale kronike. Pacientët nën trajtim me terapi renale zëvendësuese kanë risk 4-10-fish më të lartë për të bërë stroke.

Përkufizimi klasik e cilëson strokun si një deficit neurologjik nga një dëmtim akut fokal i sistemit nervor qendror me shkaqe vaskulare si infarkti cerebral, hemorragjia subaraknoidale etj duke u konsideruar kështu si një ndër sëmundjet me shkallë më të lartë vdekshmerie në botë.

Megjithatë perkufizimi klasik i strotut është më tepër një përkufizim klinik. Departamenti i Strotut i Shoqatës Amerikane të Zemrës ka bërë rishqyrtime të këtij koncepti për të gjetur një perkufizim të plotë, të saktë dhe të përditësuar në lidhje me strotun në shekullin e 21. Sipas këtyre rishqyrtimeve termi stroke duhet të përfshijë të gjitha situatat e mëposhtme: [1]

Definicioni i infarktut të SNQ: Konsiderohet vdekja e qelizave të trurit, medulës spinale apo retinës për shkak të ishemiës bazuar në:

1. patologji, të dhënave imazherike apo fakteve të tjera objektive të pranishme së një dëmtimi fokal cerebral, spinal ose retinal.
2. shenjave klinike të dëmtimit fokal ishemië të trurit, palcës apo retinës të cilat persistojnë >24 orë ose deri në vdekje pasi janë përjashtuar të gjitha shkaqet e tjera.

Definicioni i stroke ishemië: konsiderohet çdo episod me çrregullim neurologjik i shkaktuar nga infarkti i trurit, palcës apo retinës.

Përkufizimi i stroke ishemië duhet të jetë i kufizuar në isheminë fokale dhe të mos përfshijë isheminë globale.

Definicioni i hemorragjisë intracerebrale: Konsiderohet grumbullimi i gjakut në parenkimën cerebrale ose sistemin ventrikular i cili nuk shkaktohet nga trauma.

Përkufizimi i stroke të shkaktuar nga hemorragjia intracerebrale: Zhvillimi i shpejtë i shenjave klinike të mosfunksionimit neurologjik, që i atribuohet një koleksioni fokal të gjakut brenda parenkimes së trurit ose sistemit të ventrikulit, i cili nuk është shkaktuar nga trauma. (1)

Për shkak të moshës së rritur të popullatës në hemodializë dhe komorbiditeteve, shkalla e vdekshmërisë nga stroke është shumë e lartë. [2]

Pacientët me SRK janë më të predispozuar të pësojnë AVC (aksidente cerebrovaskulare) të rënda dhe të përsëritura. Për çdo ulje me 10 ml/min/1,73 m² të shkallës së filtrimit glomerular (GFR), rreziku për stroke rritet me 7%. [3-4]

Aksidentet cerebrovaskulare, kanë faktorë risku, incidencë, prevalencë të njohur për popullatën e përgjithshme. Sëmundja kronike renale kategorizohet si një faktor i pavarur risku për stroke në popullatën e përgjithshme. [2]

Pacientët në hemodializë kanë risk të shtuar për të bërë aksidente cerebrovaskulare, të cilat lidhen me një nivel të lartë vdekshmërie [3-4]. Incidenca e stroke, si për ato ishëmike dhe ato hemorragjike në hemodializë është 5-10 herë më e madhe në krahasim me popullatën e përgjithshme (në varësi të raportimit nga studime të ndryshme) [5-6-7].

Kjo lidhet me praninë e shtuar të faktorëve tradicionalë të riskut për stroke si moshë, hipertensioni, diabeti mellitus dhe dislipidemia. Nga ana tjetër ka edhe faktorë risku të lidhur me sindromën uremike, aksesin vaskular të mundshëm, disfunkcionin endotelial, aterosklerozën e përshpejtuar dhe autoregullimin cerebral të dëmtuar, [5-7] të cilët predispozojnë pacientët në hemodializë për stroke ishëmik ose hemorragjik. Hemodializa në vetvete ndikon në një menyrë unike mbi riskun për stroke [5].

11.1 Popullata në studim

Përpara se të analizojmë të gjitha rezultatet e vëzhgimit tonë, do ishte më e qartë nëse prezantonim dhe disa specifika të kësaj popullate përgjatë 10 vjecarit të fundit.

Moshë mesatare e popullatës tonë të hemodializës në 2019-2020 është 59.8 vjeç dhe kjo moshë është rritur nga viti 2008 e në vazhdim me afërsisht 10 vjet. Moshë mesatare e popullatës së hemodializës në Europë në 2020 ka qenë rreth 66 vjeç dhe në Amerikë rreth 57.4 vjeç.

Persa i perket raportit meshkuj/femrat që prej fillimit raportet kanë qenë rreth 60 % janë meshkuj dhe rreth 40% femra. Në vitin 2020 ka qenë 68.2% meshkuj dhe 32.8% femra.

Në vitin 2020 diabeti raportohet si sëmundje bashkëshoqëruese në rreth 16.6% të pacientëve të qendrave në vëzhgim, kurse në Europë shkon 21.4 % , në Amerikë 28 %.

Koha mesatare në hemodializë në 5 vitet e fundit është rreth 49 muaj, ndërsa në Europë kjo kohë është 60 muaj.

BMI e pacientëve tanë në hemodializë në 5 vjecarin e fundit është rreth 24.8.

Problematika kryesore që prej vitit 2008 e në vazhdim në të gjitha qendrat e hemodializës ka qenë aksesit vaskular (përfshijë qendrën e hemodializës Shkodër), përqindja e lartë e CVC (kateter venoz central) dhe specifiku i atyre short-term me një kohë qëndrimi mbi 90 ditë.

Përqindja e CVC në qendrat tona përgjatë këtij 10 vjecari ka qenë 30-35 % , ku një mesatare në botë shkon rreth 20-25%, por duhet thënë se varion në varësi të vendeve të ndryshme, psh Spanja ka raportuar në 2020 rreth 34 % të pacientëve me CVC.

Problematika qëndron jo thjesht në numrin e lartë të CVC short-term, por edhe në ditë qëndrimin e lartë të tyre (mbi 90 ditë). Koha e qëndrimit mbi 90 ditë e CVC luhetet rreth 32%, kjo në 5 vitet e fundit pasi fillimisht ka qenë edhe më e lartë. Në botë raportohet rreth 20-23 % e CVC që kanë kohë-qëndrimi mbi 90 dite, fakt që lidhet dhe me përqindjen e CVC long-term (të tunelizuar).

Në qendrat tona përqindjet e CVC long-term kanë ndryshuar shumë ndër vite, për të ardhur në 2020 ku raportohet një përqindje pothuajse e barabartë e CVC short-term dhe atyre të tunelizuar në qendrat e hemodializës. Nga 30% të CVC të raportuar në qendra, në total 15 % janë CVC short-term dhe 15% long-term.

FAV si akses vaskular i preferuar në hemodializë kanë një përqindje rreth 64 % ndër vite, kur një mesatare në botë shkon 70%. Kjo përqindje është në rritje të vazhdueshme dhe në vitin 2020 i është afruar mesatares botërore. Gjithsesi çdo qendër ka patur specifikat dhe përqindjet e veta të lidhura me lehtësinë e kontaktit të një mjeku angiolog.

Koha e hemodializës është një tjetër faktor cilësie dhe në 94 % pacientët tanë kryenin 720 minuta në javë, që është një përqindje mjaft e mirë.

Kt/V mesatare të paktën në vitet e fundit ishte 1.5 dhe vlera e standartizuar e saj shkonte 2.36. In Vivo Urea Clearance shkonte 220-250 ml/min. Vlera këto që shkojnë afër ose pothuajse janë të barabarta me një mesatare botërore, pasi koha e hemodializës dhe shpejtësia e pompës së gjakut në qendrat tona ishin sipas protokolleve botërore .

Problematikë që ka mbetur pothuajse e pandryshuar përgjate viteve të vëzhgimit ka qenë balanca fosfo-kalcike dhe mjekimi adekuat i saj.

Nje pikë tjetër problematike e pacientëve tanë në hemodializë ishte pesha e fituar interdialitike dhe në një mesatare rreth 17% e pacientëve shtojnë mbi 5% te peshës së tyre trupore.

11.2 Incidenca, prevalenca dhe mortaliteti

Incidenca e stroke ndryshon në varësi të studimeve të ndryshme, por është raportuar gjithmonë e lartë dhe është shoqëruar me një mortalitet të lartë, sidomos për stroke hemorragjik. [5]

Stroke ishemic në studimin tonë, bazuar në perkufizimin e AHA/ASA, klinikën e pacienteve dhe raportin radiologjik në disa raste CT dhe në disa raste RM (sipas mundësisë së qendrës ku është ndodhur pacienti), është raportuar në 52 raste (72.28%) nga 70 raste në total të përfshirë në studim, me një mortalitet 40.3%.

Në vëzhgimin tonë u vu re që përqindja e strotkut ishemic është deri diku e ngjashme me studimet e tjera në literaturë ku stroke ishemic raportohet në 80-85% të rasteve.

Stroke hemorragjik u raportua në 18 raste (25.7%) me një mortaliteti shumë të lartë prej 94.44%, që rezultoi të ishte i ngjashëm me atë që u vu re edhe në CHOICE study.

Prevalenca e stroke në grupin tonë ishte 4.01 %, duhet te themi se nuk pati ndryshime të rëndësishme midis grupit të femrave dhe meshkujve dhe as në grup moshat. (Tab 1-2)

Tabela 1. Prevalenca në varësi të gjinisë

Gjinia	Lloji i AVC		Total n=70 (%)
	Ishemik n=52 (%)*	Hemorragjik n=18 (%)	
m	27 (51.9)	10 (55.6)	37 (52.9)
f	25 (48.1)	8 (44.4)	33 (47.1)

Tabela 2. Prevalenca sipas grup moshave

Të dhëna demografike		grupet		Total	Vlera p*
		gr studim	gr kontrolli		
gjinia	m	37 52.90%	39 55.70%	76 54.30%	0.433
	f	33 47.10%	31 44.30%	64 45.70%	
grup_mosha	<=55	23 32.90%	32 45.70%	55 39.30%	0.083
	>55	47 67.10%	38 54.30%	85 60.70%	

*Hi-katror

Në total mortaliteti tek grupi i stroke ishte 82.86 % në krahasim me grupin e kontrollit ku ishte 20% (p* <0.001) dhe ky ndryshim është statistikisht sinjifikant për të kuptuar impaktin e stroke tek jetëgjatësia dhe cilësia e jetës tek pacientët në hemodializë.

CHOICE Study raportoi një incidencë me 4.9 evente /100 persona në vit. Kjo incidencë u pa se ishte më e lartë 2 vitet e para të fillimit të hemodializës [8].

Gjatë një follow-up median me 2.7 vite ata panë se 165 pacientë bënë AVC pas seancës së hemodializës. Përqindja më e lartë e atyre që bëri AVC ishin meshkuj me presion diastolik të ulët, histori për DM, histori të mëparshme të AVC apo sëmundje vaskulare periferike. Faktorët e tjerë të riskut si presioni arterial sistolik, prezenca e aritmive, hipertrofia ventrikulare kardiake dhe nivelet e kolesterolit nuk kishin ndryshime sinjifikante midis grupeve [8].

Në këtë studim 55 % e eventeve u paraprinë nga simptoma apo TIA. Në total 35 % e eventeve ishin fatale, fataliteti rezultoi në 28 % të rasteve me stroke ishemik dhe 90 % të atyre hemorragjik [8].

4D study ishte një studim që përfshiu pacientët me diabet mellitus tip II në hemodializë që u trajtuan me atorvastatinë. Ky studim tregoi se stroke u shfaq në 17.4% të pacientëve me statinë dhe në 18.2 % të pacientëve në grupin placebo. [9]

Toyoda et al bëri një studim 22 vjecar në një qendër hemodializë dhe pa se incidenca e stroke dhe lloji ndryshoi ndër vite, në fillim ishte më predominant një event hemorragjik ndërsa gjatë 5 viteve te fundit incidenca u rrit më tepër dhe ishte një event ishemik [10].

HEMO study tregoi gjithashtu se eventet ishemike ishin në përqindje më të lartë [11].

Sanchez-perales C et al tregoi një prevalencë të strotkut ishemik 6.7 % tek pacientët që fillojnë hemodializë. Kjo tregon një rënie nga studimet e mëparshme, por sërish mbetet 8 herë më e lartë sesa në popullatën e gjerë. Në këtë studim AF ishte një faktor parashikues i strotkut ishemik. [12]

Krahasuar me studimet e tjera mbi stroke shfaqia e stroke hemorragjik dhe atij ishemik ishte e njëjtë edhe në grup popullatën tonë. Prevalenca ishte relativisht më e ulët se ajo e studimeve të tjera, por kjo mund të shpjegohet nëpërmjet mos diagnostikimit të rasteve që kanë bërë exitus përpara seancës së hemodializës në shtëpi dhe nuk kanë arritur në qendrat mjeksore ose kanë arritur në një qendër mjeksore në stad terminal, ku ka qenë e pamundur diagnoza diferenciale.

Një përqindje e rëndësishme e ndodhise së stroke është gjatë 30 minutave të para të seancës së hemodializës, atëherë kur dhe ndryshimet volumore dhe elektrolitike janë më të theksuara. [10]

Koha mesatare e ndodhise së stroke në grupin në studim ishte 37.35 M për stroke ishemik dhe 23.72 M për atë hemorragjik, në total të grupit ishte 32.44 M.

Koha mediane e eventit ishte 20 M për stroke ishemik dhe 11 M për atë hemorragjik.

Nga vëzhgimi yne duket që stroke hemorragjik ka një ndodhi më të shpeshtë në fillimet e dializës dhe më pas rritet ndodhia e stroke ishemik.

Tabela 3. Mbijetesa

Vdekshmëria	Grupet		Total	Vlera p*
	Gr studim	Gr kontrollit		
vdekur	58 (82.9)	14 (20.0)	72 (51.4)	<0.001

Tabela 4. Analiza e mbijetesës

gr studim	Total Nr	Nr i vdekjeve	Koha mesatare ne HD	CI95%		Koha mediane	CI95%	
gr studim	70	58 (82.85)	36.49	24.97	48.01	17.00	9.69	24.31
gr kontrollit	70	14 (20.00)	132.56	131.79	133.32	.	.	.
Totali	140	72 (51.43)	88.75	78.47	99.05	133.00	126.82	139.18

11.3 Faktorët e riskut

Faktorët e riskut për stroke tek pacientët në hemodializë mund ndryshojnë nga ato të popullatës së përgjithshme dhe deri diku edhe nga faktorët e riskut për stroke përpara fillimit të hemodializës, cka e bën më specifik vëzhgimin tonë.

Pacientët me hemodializë kanë një prevalencë të lartë të kardiomiopatisë, sëmundjeve koronare dhe fibrilacionit atrial, [13-14] dhe të gjithë këta janë faktorë të fuqishëm risku për stroke. Pacientët me hemodializë gjithashtu kanë një prevalencë më të lartë të faktorëve tradicionalë të riskut kardiovaskular, siç janë mosha më e vjetër, hipertensioni, dislipidemia dhe diabeti [13-14].

Edhe pse këta janë faktorë risku të pranuar në popullatën e përgjithshme, studimet vëzhguese të pacientëve me hemodializë tregojnë se si presioni i ulët i gjakut ashtu edhe niveli i ulët i glukozës shoqërohen me ngjarje kardiovaskulare dhe vdekshmëri më të lartë [15-16].

Aktualisht nuk ka të dhëna të kontrolluara tek pacientët me hemodializë për të mbështetur efektin e përdorimit të statinave, presionin specifik të gjakut ose agjentët antidiabetikë,

vlera target për presionin e gjakut dhe kontrollin e glicemise ose përdorimin e antikoagulantëve për fibrilacionin atrial. [17-18]

Gjithashtu ka mundësi që të kemi një përfitim të ulët përballë riskut të presionit të ulët të gjakut dhe niveleve të ulëta glukozës në gjak tek pacientët me hemodializë duke pasur parasysh sëmundjen e tyre të përparuar vaskulare dhe riskun më të lartë të efekteve anësore. [95].

Luhatjet e përsëritura të presionit arterial mund të predispozojnë drejt stroke hemorragjik dhe ishemik [26]. Pacientët në hemodializë marrin rregullisht antikoagulum si pjesë e trajtimit të tyre, gjë që mund të rrisë rrezikun e stroke hemorragjik [26].

Pacientët me hemodializë gjithashtu janë të ekspozuar edhe ndaj faktorëve të riskut të lidhur me ureminë, të cilat mund të rrisin riskun e stroke [19-20].

Këta faktorë përfshijnë nivele të larta të inflamacionit dhe stresit oksidativ, [19-20] aneminë ose trajtimi i saj me agjentë stimulues të eritropozës, [21-22] ndryshime në metabolizmin mineral, duke përfshirë hiperfosfateminë, hiperparatiroidizmin sekondar dhe mungesën e 25-hidroksivitaminës D, [23-24] si edhe ruajtja e faktorëve të rinj qarkullues, të tilla si dimethylarginine asimetrike (ADMA), një frenues i oksidit nitrik. [25]


11.4 Mosha dhe gjinia

Mosha përfaqëson një faktor të pamodifikueshem risku si në popullatën e përgjithshme ashtu dhe në atë të hemodializës. Në popullatën e përgjithshme shihet një lidhje e drejtë midis moshës dhe riskut për stroke [7] .

Selinger et al referoi se kjo lidhje nuk është sinjifikante në popullatën e hemodializës. [6]

Në studimin tonë nuk u vu re ndonjë ndryshim sinjifikant ndërmjet grupit të stroke dhe atij të kontrollit.

Grafiku 1. Paraqitja e rasteve sipas grup-moshës (%)



Në grupin e stroke moshë mbi 55 vjeç rezultoi 32.90% , ndërsa në grupin e kontrollit 45.70 % (p*0.083 ndryshim jo i rëndësishëm statistikiisht).

Megjithatë ky fakt mbetet për tu ri-interpretuar sërish pasi moshë mesatare e popullatës tonë në hemodializë është në rritje në 5 vitet e fundit.

Gjinia femër ka rezultuar në shumë studime si faktor i pamodifikueshëm risku për stroke në popullatë, por edhe në hemodializë. Është vënë re se pacientet femra në hemodializë kanë një prevalencë më të lartë për stroke dhe gjithashtu një risk më i lartë për infarkte hemorragjike. [2]

Në vëzhgimin tonë nuk u konstatua një lidhje statistikore midis gjinisë dhe një eventuale stroke. Grupi i stroke kishte 47.1% femra dhe ai i kontrollit 44.30%, ndërsa meshkujt ishin respektivisht 52.90 % në grupin e stroke dhe 55.70 % në grupin non-stroke, (vlera e p* 0.433).

Stroke ishëmiq ndodhi tek 25 femra (48.1%) dhe 27 meshkuj (51.9) ndërsa stroke hemorragjike ndodhi tek 10 meshkuj (55.6%) dhe 8 femra (44.4).

Por ne kemi raportuar në vitin 2018 në popullatën tonë të hemodializës një numër më të madh të meshkujve në hemodializë me një përqindje 64.8 % meshkuj dhe 35.2 % femra.

11.5 Hipertensioni

Tek adultët e shëndetshëm, ekziston një korelacion midis vdekshmërisë në stroke dhe presionit të gjakut: për çdo 20 mmHg rritje të presionit sistolik të gjakut (TA S) ose rritje prej 10 mmHg në presionin diastolik të gjakut (TA D), shkalla e mortalitetit nga stroke dyfishohet (27-28).


Ulja e presionit të gjakut në provat e rastit shoqërohet me një ulje të rrezikut të krahasueshëm, duke konfirmuar që kjo marrëdhënie është shkaksore. Pra të dyja vlerat ekstreme të TA janë një faktor risku për stroke ishemik ose hemorragjik. [27]

Edhe në popullatën e hemodializës vlerat e TA kanë një lidhje të drejtë me riskun për stroke megjithëse nuk ka vlera target të tensionit tek pacientët në hemodializë.

Selinger et al tregoi se vlerat e TA ishin një faktor parashikues për stroke dhe çdo rritje e TA me 10mmHg lidhej me një rritje të riskut për stroke me 11%. [29]

Megjithëse nivelet target të TA nuk janë të qarta, disa udhëzime klinike sugjerojnë mbajtjen e TA në vlera <140/90 mmHg. [31] Sidoqoftë, vlerat optimale të TA duhet të përcaktohen për secilin pacient individualisht duke patur parasysh komorbiditetin. [30]

Grafiku 2. Trajtimi i HTA sipas numrit të medikamenteve



Në studimin tonë u pa një lidhje të rëndësishme midis vlerave të TA dhe ndodhjes së stroke. Sipas vlerave të tensionit pacientët u ndanë në 4 grupe: pa mjekim, me 1 anti-HTA, me 2 anti-HTA, me 3 anti-HTA, me 4 anti-HTA.

Tabela 5. Antihipertensivët

HTA/ mjekimi	Grupet		Total n=140 (%)
	Gr Studim n=70 (%)	Gr kontrolli n=70 (%)	
Pa mjekim	2 (2.8)	30 (42.9)	33 (27.6)
vetem 1 medikament	3 (4.8)	3 (4.8)	6 (8.57)
2 medikamente	28 (40.0)	28 (40.0)	56 (80.0)
3 medikamente	25 (35.7)	8 (11.4)	33 (23.6)
4 medikamente	12 (17.1)	1 (1.4)	13 (9.3)

Në të dyja grupet predominonin pacientët nën trajtim me 2 antihipertensivë (n=28) dhe në grupin e stroke kishte një përqindje më të lartë të pacienteve që trajtoheshin me 3 antihipertensivë (35.71 % kundrejt 11.42% në grupin e kontrollit) dhe me 4 antihipertensivë (17.14% kundrejt 1.42 në grupin e kontrollit). Pacientet pa mjekim ishin në vlera të larta në grupin e kontrollit, 42.85%.

Studime të mëparshme treguan një marrëdhënie në formë J në pacientët me SRK me TA sistolik<120 mm Hg të shoqëruar me një rrezik 2.5 herë më të madh për stroke. [32]

Rezultatet nga studime të shumta në pacientët me hemodializë janë shumë më pak bindëse. Të paktën tre studime nuk kanë gjetur asnjë lidhje të pavarur midis riskut për stroke dhe vlerave të presionit arterial [33-34-12], ndërsa dy studime të mëdha kanë gjetur vetëm shoqërim pozitivisht të dobët [35-36]. Sipas një studimi që përfshinte 8920 pacientë me hemodializë në US, presioni arterial përpara seancës (rezultatet e veçanta sistolike dhe diastolike nuk u prezantuan) nuk shoqërohej me rritjen e riskut për stroke (raporti i pa rregulluar i rreziqeve [HR] 1, 00, 95% CI 0, 95-1.05). [37] Pas rregullimit të mundshëm, çdo rritje prej 10 mmHg në presionin arterial mesatar të pre-hemodializës shoqërohej vetëm me një rrezik të shtuar prej 11% për stroke. [37-38]

Ekzistojnë disa arsye pse këto analiza mund të kenë nënvlerësuar madhësinë e vërtetë të çdo efekti negativ të presionit arterial tek pacientët me hemodializë.

- Së pari, matja e presionit të gjakut pasi sëmundja renale kronike ka përparuar deri në fazën e ESRD, që kërkon trajtim me hemodializë mund të mos përfaqësojë ekspozimin e kaluar sepse:

(a) presioni i gjakut modifikohet si nga hemodializa ashtu edhe nga medikamentet, dhe përgjithësisht trajtohet në një objektiv udhëzues. [39]

(b) hipertensioni i hershëm (dhe sëmundjet e tjera kardiovaskulare) mund të çojë në uljen e presionit arterial duke zvogëluar kontraktilitetin kardiak [40-41].

Shumica e pacientëve me hemodializë kanë evidence të sëmundjes strukturore të zemrës e cila përkeqësohet me rritjen e kohës në hemodializë [42]. Meqenëse kardiopatia hipertensive mund të ulë presionin e gjakut dhe të rrisë riskun për stroke, prania e saj jo vetëm që mund të dobësojë shoqërimin e vëzhguar midis presionit të gjakut dhe stroke, madje mund ta kthejë atë, duke rezultuar në një shoqërim në formë "J" ose "U" midis presionit të gjakut dhe rezultateve të pafavorshme (ky lloj paragjykimi cilësohet si kauzalitet i kundërt). [43-44]

- Së dyti, është e rëndësishme të merren parasysh matjet e ndryshme të presionit të gjakut.

Presioni i lartë i gjakut tek pacientët me hemodializë rezulton nga rritja e volumit jashtëqelizor, rritja e aktivitetit të sistemit nervor simpatik dhe “ngurtësia” vaskulare [45-46]. “Ngurtësia” vaskulare zvogëlon kompliancën sistolike dhe lëshimin diastolik [46-47] duke rritur S-TA ndërsa ul njëkohësisht D-TA. Leximet diastolike dhe mesatare të presionit të gjakut janë ekspozime më të ndërlikuara për t'u marrë parasysh në këtë popullatë.

- Së treti, ndryshimi diurnal (24-h) në presionin e gjakut tek pacientët me hemodializë mund të jetë i konsiderueshëm, veçanërisht në ditët e hemodializës.

TA prehemodializë është dukshëm më i madh se mesatarja ditore e TA (siç vlerësohet nga matjet ambulatorë), dhe regjistrimet e TA të posthemodializës janë dukshëm më të ulëta. [48] Luhatja ditore e presionit të gjakut brenda individëve do të thotë që një lexim i vetëm mund të mos jetë indikator i presionit të gjakut "të zakonshëm" të një pacienti dhe mund të rezultojë që pacientët të kategorizohen. Në matjen e përsëritur, presioni i gjakut i një individi ka tendencë të jetë më i përafërt me popullatën sesa në matjen e parë.

Tek, the Study of Heart and Renal Protection SHARP [49] të dhënat e S-TA të pacientëve me hemodializë u ndanë nga kuintilet bazuar në një matje të vetme bazë, ato në kuintilin më të lartë kishin një S-TA mesatare prej 171 mmHg. Regresioni i vëzhguar ndaj mesatares në SHARP është tipik, dhe nëse nuk merret parasysh nga studimet vëzhguese, rëndësia e S-TA në stroke do të nënvlerësohet sistematikisht nga studime të tilla. Kjo do të nënkuptonte që nëse raporti i riskut për shoqërim midis një matjeje të vetme të S-TA dhe stroke në një studim vëzhgues të pacientëve me hemodializë ishte 1.2 për 20 mmHg S-TA më e lartë, rëndësia e S-TA "të zakonshme" në stroke do të të ketë një risk të rritur me 1.9 herë për 20 mmHg.

Kjo do të thotë që vëzhgimet në grupet e hemodializës duhet të interpretohen me kujdes. Në rastin e presionit të gjakut, lidhja në dukje e dobët midis presionit të gjakut dhe stroke në hemodializë nuk duhet të interpretohet si justifikim për objektiva më të “butë” të presionit të gjakut dhe objektivat optimale për të trajtuar faktorët e rrezikut të modifikueshëm që mund të preken nga shkakësia e kundërt nuk duhet të identifikohet duke ekzaminuar pikën më të ulët në kthesat e shoqërimin në formë "J" ose "U".


Megjithatë, synimi optimimumit terapeutik të presionit të gjakut në pacientët me hemodializë mbetet i pasigurt.

Në studimin tonë dokumentuam vetëm praninë e hipertensionit dhe numrin e medikamenteve antihipertensive që ata përdornin. Nuk dokumentuam vlerat mesatare të TA gjatë seancës së hemodializës.

11.6 Ateroskleroza cerebro-vaskulare dhe përdorimi i medikamenteve që ulin LDL-kolesterolin

Në të dy grupet e vëzhguara u vu re se kolesteroli përbën një faktor risku për stroke (201.75 mg/dl stroke dhe 164.75 mg/dl grupi i kontrollit $p^* < 0.001$) megjithëse u konstatua se vlerat e vëzhguara nuk ishin të larta.

Grafiku 3 .Vlera mesatare e kolesterolit, sipas grupeve



Ne dokumentuam vlerat e kolesterolit total dhe duhet të nënvizojmë faktin që këto vlera nuk ishin shumë të larta në asnjërin nga grupet.

Pacientët e hemodializës përfaqësojnë një grup specifik, ku mjekimi për hiperkolesteroleminë duhet analizuar jashtë targetave të popullatës së përgjithshme [51].

Në pacientët me hemodializë nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të vëne në dukje ndonjë bashkëshoqërim midis vlerave më të larta të kolesterolit dhe vdekshmërisë. Në fakt është vënë re se pacientët me vlera shumë të ulëta të kolesterolit total kanë rrezik më të lartë vdekshmërie dhe ekziston një marrëdhënie e sheshtë në nivelin e kolesterolit brenda intervalit "normal" [51].

Sipas hipotezave prania e inflamacionit mund të shpjegojë shoqërimin negativ në përqendrime të ulëta të kolesterolit total, pasi inflamacioni mund të pengojë sintezën e kolesterolit dhe të shoqërohet me rritje të riskut për sëmundje kardiovaskulare [47]. I njëjti paragjykim mund të ngatërrojë korelacionet midis vlerave të kolesterolit dhe stroke tek pacientët në hemodializë, tek të cilët nuk është vënë re ndonjë lidhje e qëndrueshme midis non-high-density lipoproteine (non- HDL) ose përqendrimit të kolesterolit LDL dhe rrezikut të stroke [47].

Analizat e papërshtatura nga një regjistër japonez i pacientëve me hemodializë 45.390 zbuluan se as vlerat më të larta të non-HDL kolesterolit, as vlerat më të larta të LDL kolesterolit nuk ishin të lidhura me rrezikun e stroke ishemic, derisa të shqyrtohej shkalla bëhej rregullimi për parashikimin e humbjes proteinike dhe inflamacionit. Pas një rregullimi të tillë, madhësia e shoqërimit midis non-HDL kolesterolit më të lartë dhe stroke ishemike në pacientët me hemodializë, (HR për 39 mg /dl më të lartë kolesterol jo-HDL = 1.11, 95% CI 1.04-1.19) (18), ishte e ngjashme me shoqërimin e rregulluar të vërejtur tek të rriturit në dukje të shëndetshëm (HR për 43 mg / dl më të lartë non-HDL kolesterol = 1.12, 95% CI 1.04–1.20) [52].

Në një gamë të gjerë të popullatave me rrezik të lartë, ulja e LDL kolesterolit me regjime të bazuara tek statinat zvogëlon ndjeshëm riskun e strotkut ishemic [53]. Studimet e randomizuara, duke shmangur bias inherent (e pandare) të studimeve vëzhguese, kanë treguar se LDL kolesteroli shërben si një faktor rreziku për ngjarje të mëdha aterosklerotike (përfshirë stroke ishemike) tek pacientët në SRK në fazë të avancuar, duke ilustruar kështu vështirësinë për t'u mbështetur në studime vëzhguese për të udhëhequr vendime terapeutike tek pacientet me SRK (ose në të vërtetë në çdo popullatë) [53].

SHARP demonstroi që ulja e LDL kolesterolit me 33 mg/dl në 9270 pacientë me SRK, pa një infarkt të mëparshëm të miokardit (MI) ose revaskularizim koronar, zvogëlon rrezikun e ngjarjeve kryesore aterosklerotike me 17% (RR 0.83; 95% CI 0.74-0.9.9) [49]. Kjo përfshin një ulje të konsiderueshme të riskut për një stroke jo-hemoragjike (RR 0.75; 95% CI 0.60-0.94) [49].

Kishte përfitime të krahasueshme proporcionale për ngjarje të mëdha aterosklerotike në pacientët tashmë në hemodializë dhe ato që nuk ishin (provë për heterogjenitetin $p=0.25$), dhe parashikohej që pacientët të cilët janë në hemodializë të përfitojnë më shumë, në terma absolutë, për shkak të riskut më të lartë fillestar të një ngjarjeje aterosklerotike [49].

SHARP demonstroi gjithashtu se ulja intensive e LDL kolesterolit në CKD të përparuar është e sigurt, prandaj ulja e LDL kolesterolit me terapi të bazuar në statinë duhet të konsiderohet pjesë kryesore e çdo strategjie për të ulur riskun e stroke ishemike tek pacientët me hemodializë dhe risqet e tjera të sëmundjes aterosklerotike. [54]

11.7 Fibrilacioni Atrial

Në grupin e stroke ne vumë re se AF ishte i pranishëm në 22.90% të rasteve dhe në atë të kontrollit në 10.00% të rasteve (p*0.033). Kjo bën AF të shërbeje si një faktor risku për grupin tonë të popullatës megjithëse jo shume i fortë si faktor.

Tabela 6. Sëmundjet shoqëruese

Patologji shoqëruese		Grupet		Total	Vlera p*
		Gr studim	Gr kontrollit		
<i>Hepatit</i>	poz	18 (27.5)	26 (37.1)	44 (31.4)	0.101
	neg	52 (74.3)	44 (62.9)	96 (68.6)	
<i>Çrregullim ritmi</i>	FA	16 (22.9)	7 (10.0)	23 (16.4)	0.033
	Ritem sinusal	54 (77.1)	63 (90.0)	117 (83.6)	
<i>HTA</i>	po	68 (97.2)	40 (57.1)	107 (72.4)	<0.001
	jo	2 (2.8)	30 (42.9)	33 (27.6)	

*Hi-katror

Tabela 7. Antikoagulimi dhe llojet e aksesit vaskular

Variablet		grupet		Total	Vlera p*
		gr studim	gr kontrollit		
<i>antikoag</i>	heparine	64 (92.8)	61 (87.1)	125 (89.9)	0.207
	clexan	5 (7.2)	9 (12.9)	14 (10.1)	
<i>Akses vascular</i>	FAV	21 (30.0)	52 (75.4)	73 (52.5)	<0.001
	CVC	49 (70.0)	17 (24.6)	66 (47.5)	

*Hi-katror

Hipertrofia e ventrikulit të majtë është e pranishme tek pacientet në faza të përparuara të SRK dhe shpesh shoqërohet me dilatatim të ventrikulit, aterosklerozë të koronareve me kalcifikim dhe ngurtësi të rritur arteriale [55]. Si pasojë e këtyre fakteve manifestohet insuficienca kongjestive e zemrës në rreth një të tretën e pacientëve me incidencë për hemodializë [55].

Fibrilacioni atrial (AF) vihet re në një përqindje të lartë në pacientët amerikanë nën trajtim me HD përtaktësit: 13% e pacientëve të moshës 65-75 vjeç; 19% e moshës 75-85 vjeç ; dhe 23% e atyre mbi 85 vjet kanë një histori të AF [56].

Sipas studimit Framingham u demonstrua se AF rrit rrezikun e stroke në 5-fish [57]. Nga ana tjetër vetë ulja e GFR në SRK rrit bindshëm mundësinë e komplikimeve tromboembolike të AF sic u vertetua tek studimi Atria [58]. Përkatësisht, AF tek pacientët me hemodializë është shoqëruar me një rritje të konsiderueshme të rrezikut për stroke ishemic 5-8-fish [33-59-60].

Studime të randomizuara kanë treguar që antikoagulimi zvogëlon riskun për stroke tromboembolik në AF-t tek pacientët nga popullatat jo-dialitike dhe ka një përfitim neto tek ata me risk të moderuar/ të lartë [61-62-63].

Meta-analiza e studimeve të gjera për frenuesit direkt të trombinës dabigatran dhe frenuesit e faktorit Xa (rivaroxaban, apixaban, dhe edoxaban) ka demonstruar që këta agjentë të rinj janë po aq efektive sa varfarina në parandalimin e strotkut ishemic dhe ka më pak të ngjarë të shkaktojë një stroke hemorragjik [64].

Të gjithë këta antikoagulantë të rinj eliminohen (të paktën pjesërisht) nga veshkat, por pak pacientë me SRK në stadi të avancuara u përfshinë në studimet përfundimtare. Aktualisht, asnjë nga këta agjentë nuk ka aprovim të qartë / indikacion për përdorim në pacientët me hemodializë [65].

Për sa i përket varfarinës tek pacientët në hemodializë ekzistojnë disa probleme, jo vetëm sepse rreziku i hemorragjisë përpara trajtimit është i lartë [66], por edhe sepse frenimi i karboksilimit të varur nga vitamina K i proteinës së matrix Gla (një frenues i kalcifikimit) rrit mundësinë që varfarina të përshpejtojë kalcifikimin arterial dhe në këtë mënyrë të rrisë rrezikun e strotkut ishemic jo kardioembolike (dhe sëmundjes tjetër vaskulare) [58-67-68].

Për këtë shkak ka rekomandime që pacientët me hemodializë me AF jo valvulare nuk duhet të konsiderohen në mënyrë rutinë për tromboprofilaksi [67]. Megjithatë nuk ka asnjë provë rastesore në shkallë të gjerë në hemodializë për të mbështetur këtë tablo .

11.8 Çrregullimet mineralo-kockore dhe trajtimi i tyre

Ndër parametrat që u rregjistruan në studimin tonë ishin edhe vlerat e kalciumit total dhe të jonizuar, fosforemia, PTH dhe Vit D.

Kalciumi total në vëzhgimin tonë tek grupi i stroke ishte në vlerat mesatare 8.52 mg/dl dhe në grupin e kontrollit në vlerat 8.74 mg/dl, (p=0.081), pa ndonjë ndryshim statistikisht të

rëndësishëm. Kur analizojme vlerat e kalciumit të jonizuar rezulton 1.15 mg/dl në grupin e stroke dhe 1.22 mg/dl në grupin e kontrollit ($p=0.004$), me një ndryshim statistikor relativisht të rëndësishëm.

Vlerat mesatare të PTH ishin 625.50 pg/mL në grupin e stroke dhe 765.11 pg/mL në grupin e kontrollit, ($p=0.241$), që vlerësohet si lidhje e parëndësishme për stroke

1-25-hidroksi Vit D ishte në vlera mesatare 16.26 ng/mL dhe në grupin e kontrollit 26.82 pg/mL, ($p= 0.010$), jo statistikisht i rëndësishëm.

Fosforemia rezultoi mesatarisht 5.34 mg/dl në grupin total të stroke dhe 5.69 mg/dl në grupin e kontrollit. Ajo që ishte interesante ishte se vlerat e fosforemisë ishin më të ulta tek grupi i femrave me stroke ishemic 4.42 mg/dl, ($p 0.048$). Sipas Q-cohort study u pa se femrat me vlera të ulta të fosforemisë kishin një prevalencë më të lartë për stroke ishemic dhe i njëjti fakt ishte i pranishëm edhe në studimin tonë. [74]


Kalcifikimi arterial medial i enëve intrakraniale po përhapet gjithnjë e më shumë me rritjen e moshës dhe dëmtimet e funksionit të veshkave [69]. Kalcifikimi rezulton në rritjen e trashësisë së murit të enës dhe ngurtësisë, e cila rrit TA sistolik dhe shpejtësinë e valës së pulsit (të dyja shoqërohen me risk të lartë për stroke [28-70] dhe vdekjen nga stroke [46-47]).

Çrregullimi mineral dhe kockor (Mineral Bone Disorder MBD) mund të kontribuojë në kalcifikimin e përshpejtuar të enëve të gjakut [71], dhe ndryshimin e markuesve të tij (fosfori serik i rritur, kalciumi, parathormoni [PTH] dhe përqendrimi i FGF 23) dhe është i shoqëruar në mënyrë të pavarur me rritjen e vdekshmërisë tek pacientët në hemodializë [72-73]. Sidoqoftë, një rol esencial për çrregullimin kockor dhe mineral në sëmundjet kardiovaskulare (përfshirë stroke) ende nuk është demonstruar.

Në studimin tonë nuk u vu re asnjë lidhje midis stroke dhe niveleve të PTH ose të vit D.

Lidhja më e rëndësishme në këtë bosht ishte ajo me kalciumin e jonizuar. Vlerat e ulta të kalciumit të jonizuar ishin të lidhura, megjithatë jo në një mënyrë të fortë, me stroke. Vlera e kalciumit të jonizuar në grupin e stroke ishte 1.15 mg/dl dhe në grupin e kontrollit 1.22 mg/dl, ($p=0.004$).

Grafiku 4 .Vlera mesatare e kalciumit të jonizuar, sipas grupeve



Studime të randomizuara të lidhësve të fosforit nuk kanë mundësuar aq sa duhet prova për efektin e kësaj ulje të fosforit tek përfundimet kardiovaskulare [75] dhe gjithashtu ulja e PTH me rreth 250 pg/mL dhe përqendrimit të kalciumit me rreth 0.4 mg /dl tek 3883 pacientë në që trajtohen me hemodializë tek studimi, Evaluation of Cinacalcet Hydrochloride Therapy to Cardiovascular Events (EVOLVE) nuk pati ndonjë efekt domethënës në rezultatin parësor të vdekjes, infarkt të miokardit, shtrimin në spital për anginë të paqëndrueshme, insuficiencës kardiake, ose të një ngjarje vaskulare periferike (HR 0.93, 95% CI 0,85-1.02); informacion mbi efektin e veçantë në stroke nuk u paraqit. [76].

11.9 Faktorët e lidhur me hemodializën


Vlerat e azotemisë, creatinemisë dhe adekuanca e seancës

Në studimin tonë u regjistruan vlerat e azotemisë dhe kreatinemisë përpara seancës së hemodializës, URR dhe Kt/V në muajin e ndodhisë së eventit.

U vu re se vlerat e azotemisë përpara seancës ishin në një mesatare 159.66 mg/dl në grupin e stroke dhe në vlerat 140 mg/dl në grupin e kontrollit, (p=0.003) .


Vlerat e URR ishin mesatarisht 64.78 % në grupin e stroke dhe 67.93 % në grupin e kontrollit, (p=0.042).

Grafiku 5. Vlera mesatare e azotemisë, sipas grupeve



Vlerat e azotemisë dhe kreatinemisë përpara seancës kishin një lidhje të qartë me ndodhinë e stroke. Ndërsa vlerat e URR kishin një lidhje të dobët, por kjo duhet parë edhe në vlerën mesatare të URR, ajo ishte më e ulët se niveli target të percaktuara duke treguar kështu një problem të ndodhur ose me vlera tepër të larta të azotemise në hyrje ose në perfundim të seancës, si pasojë e problemeve me aksesin vaskular, ose si pasojë e dietës.

Grafiku 6. Vlera mesatare e kreatinemisë, sipas grupeve



Vlerat mesatare të kreatinemisë ishin $9.14 + 2.27$ tek grupi i stroke dhe $10.49 + 2.23$ tek grupi i kontrollit me një vlerë të $p=0.001$.

11.10 Koha e eventit

Nga 70 raste të dokumentuara me stroke, 26 stroke ndodhën përgjatë 6 mujorit të parë të fillimit të hemodializës (32.8 %) , që është edhe periudha më e rishikuar në këtë grup-popullatë . Përgjatë periudhës 6-9 mujore ndodhia ishte në 3 raste (4.28%) , 7 raste ishin 9-12 muaj(10%) 12 raste ishin në periudhën mbi 12-24 mujore (17.14%) dhe 25 raste (35.71%) në periudhën mbi 24 muaj.


Rreth 47.14% e eventeve ndodhën përgjatë 12 muajve të fillimi të dializës (sipas kohës që ne dokumentuam).

Në 9 mujorin e parë, nga 26 raste (37.14%), 19 evente ishin stroke ishemik dhe 7 stroke hemorragjik ,(mbijetesa 1 stroke ishemik).

Mbi 24 muaj nga 25 raste , 19 evente ishin stroke ishemik dhe 6 stroke hemorragjik, (mbijetesa 7 stroke ishemik).

Koha mesatare në hemodializë ishte $27.20 + 31.07$ muaj tek grupi i stroke dhe $116.34 + 20.38$ muaj tek grupi i kontrollit me një vlerë të $p < 0.001$.

Grafiku 7 . Koha mesatare në hemodializë, sipas grupeve



Të dhënat nga United States Renal Data Service (USRDS) [4] sugjerojnë se risku për stroke është 4 herë më i lartë në muajin e parë pas fillimit të hemodializës. [10,2]. Për këtë arsye janë ngritur hipoteza se procesi i hemodializës është një "test i stresit" dhe është përgjegjës për riskun e shtuar tek pacientët me hemodializë, dhe një opsion është duke shkaktuar perfuzion cerebral të ulur gjatë ultrafiltrimit ose episodet e hipotensionit intradialitik, apo qoftë dhe duke rritur riskun e stroke hemorragjik si pasojë e përdorimit të antikoagulantëve gjatë seancës (pavarësisht se hemodializa gjithashtu ul/heq riskun e hemorragjisë uremike). [2]

Sipas Murray A. et al incidenca rritet 4 herë më tepër se niveli fillestar në pacientët ambulator dhe 7 herë më tepër se niveli fillestar tek pacientët spitalorë (2). Në të dy grupet, përqindja e stroke bie me shpejtësi në 1 deri në 2 muaj pas fillimit, vlerat më pas luhaten dhe gradualisht stabilizohen në afërsisht dyfishin e nivelit fillestar pas një viti nga fillimi i stroke. Shkalla kulmore e stroke gjatë muajit të fillimit është afërsisht dy herë më e lartë për pacientët ambulator krahasuar me pacientët spitalorë dhe shkalla e goditjes është rreth 30% më e lartë për pacientët spitalorë pas fillimit të stroke (2).

Kur ekzaminohet koha e stroke, duket se ka një rritje të paraqitjes së stroke gjatë kohës së një seance hemodialize. Shumica e pacientëve me hemodializë kalojnë rreth 7% të javës së tyre (12 orë në javë) në hemodializë.

